


RAPORTI
I VLERËSIMIT TË JASHTËM
PËR PROGRAMIN E STUDIMIT MASTER PROFESIONAL NË
“TEKNIKË E LARTË NË LABORATORË MJEKËSORË”, OFRUAR NGA
KOLEGJI UNIVERSITAR “LOGOS”

Eksperti i vlerësimit të jashtëm:

Prof. As. Etleva Refatllari

Dr. Nevila Heta



(Korrik/2018)

RAPORT I GRUPIT TË VLERËSIMIT TË JASHTËM

Për programin e studimit Master Profesional në “Teknikë e Lartë në Laboratorë Mjekësorë”

Tabela e të dhënave të licencimit për programin e studimit:		
1	IAL Aplikues:	Kolegji Universitar “LOGOS”
2	Fakulteti që e ofron	Fakulteti i Shkencave të Aplikuara
3	Urdhëri/VKM i licencimit/ Urdhër Riorganizim	Urdhër Nr. 335, datë 16.08.2013, të Ministrit të Arsimit dhe Shkencës ¹ Urdhër Nr. 428, datë 22.09.2017 të Ministrit të Arsimit, Sportit dhe Rinisë ²
4	Titulli i programit të studimit:	Teknikë e lartë në laboratorë mjekësorë
5	Cikli i studimit:	Cikli i dytë
6	Kohëzgjatja e programit të studimit:	1 vit akademik
7	Kreditet në total (ECTS):	60 ECTS
8	Forma e studimit (me kohë të plotë/të pjesshme/në distancë/):	Me kohë të plotë
9	Gjuha (shqip/tjetër):	Shqip
10	Programi ofrohet nga institucioni	Po
11	Programi ofrohet në bashkëpunim me institucione të tjera	Jo
12	Diplomë e përbashkët (shëno emërtimin):	-
13	Diplomë e dyfishtë (shëno emërtimin):	-
14	Niveli në Kornizën kombëtare të kualifikimeve	7
15	Aktivizimi i programit të studimit	2017 – 2018 (60 ECTS)
16	Brezi i parë i diplomimit të studentëve	2017 – 2018 (60 ECTS)
17	Nr i studentëve 2017 - 2018 (60 ECTS)	35 studentë

¹ Programi është hapur me Urdhër Nr. 335, datë 16.08.2013, të Ministrit të Arsimit dhe Shkencës, dhe është ofruar me 90 kredite (ECTS), me kohëzgjatje normale 1.5 vite akademike.

² Programi është riorganizuar me urdhër Urdhër Nr. 428, datë 22.09.2017 të Ministrit të Arsimit, Sportit dhe Rinisë, dhe që prej vitit akademik 2017 -2018 ofrohet me 60 kredite (ECTS) dhe me kohëzgjatje normale 1 vit akademik.

HYRJE

Të dhëna për programin e studimit Profesional në “Teknikë e Lartë në Laboratorë Mjekësorë”

Shkolla e Lartë Private (SHLP) Logos është institucion i arsimit të lartë i krijuar në vitin 2009 (liçensuar me vendimin e Këshillit të Ministrave nr. 1055 dt. 29.07.2009). Ky institucion i arsimit të lartë është ngritur mbi eksperiencën 10 vjeçare të Institutit të Formimit Profesional “Frymë Dashurie”, shkollë jo publike 2 vjeçare, një ndër të parat shkolla profesionale për përgatitjen e Laborantëve Mjekësorë. Në vitin 2017, SHPL Logos ka marrë statusin Kolegji Universitar (KU) LO (Urdhër i Ministres së Arsimit dhe Shkencës Nr. 93, dt. 06.03.2017)

Kolegji Universitar “Logos” është i organizuar në dy Fakultete:

1. Fakulteti i Shkencave Ekonomike, me tre njësi bazë, përkatësisht tre departamente, Financë-Kontabilitet, Menaxhim Biznes dhe Menaxhim Turizmi.
2. Fakulteti i Shkencave të Aplikuara, me tre njësi bazë, përkatësisht dy departamente dhe një Qëndër e Kërkimit Shkencor (Departamenti Teknikë i Lartë në Laboratorë Mjekësorë; Departamenti Informatikë e Zbatuar dhe Qendra për Kërkim dhe Zhvillim Shkencor). Ky fakultet ofron programet e studimit të ciklit të parë “Bachelor” me kohë të plotë në:
 - Teknikë i Lartë në Laboratorë Mjekësorë
 - Informatikë e Zbatuar

Fakulteti ofron dhe programin e ciklit të dytë Master Profesional në Teknikë e Lartë në Laboratorë Mjekësorë.

SHLP Logos është akredituar institucionalisht me Urdhër të Ministrit të Arsimit dhe të Shkencës Nr. 282 datë 4.07.2012 bazuar në vendimin Nr.338 datë 8.06.2012 të Këshillit të Akreditimit të Arsimit të Lartë.

Bazuar në urdhërin nr. 335 datë 16.08.2013 të Ministrit të Arsimit dhe Shkencës SHLP Logos hapi programet e ciklit të dytë të studimeve Master Profesional në degët:

- Financë Kontabilitet
- Teknikë e Lartë në Laboratorë Mjekësorë

Pas pezullimit të përkohshëm me vendim të Këshillit të Ministrave nr. 540 datë 6.08.2014, SHLP Logos iu nënshtrua ristrukturimit duke respektuar rekomandimet përkatëse. KU Logos ka marrë akreditim institucional me vendim nr. 95 dt. 20.10.2017 të bordit të akreditimit të ASCAL.

Pas plotësimit të dokumentacionit për riorganizimin e programit të studimit Master Profesional në “Teknikë e Lartë në Laboratorë Mjekësorë” mbështetur në kuadrin e ri ligjor, KU Logos ka paraqitur pranë ASCAL raportin e vlerësimit të brendshëm dhe dokumentacionin shoqërues për akreditimin e programit të studimit Master Profesional në Teknikë e Lartë në Laboratorë Mjekësorë.

Kërkesa për hapjen dhe konsolidimin e programit të studimit Master Profesional në Teknikë e Lartë në Laboratorë Mjekësorë është e mbështetur në:

- Përvojën shumëvjeçare dhe traditën në përgatitjen e specialistëve të niveleve Laborant (program profesional 2 vjeçar) dhe Bachelor në Teknikë e Lartë në Laboratorë Mjekësorë.
- Kërkesën e studentëve të arsimuar në këtë institucion dhe më gjerë për të rritur nivelin e dijeve në përputhje me kërkesat e tregut të punës.
- Ambicien e vetë institucionit për plotësimin e ciklit të plotë të studimit në Teknikë e Lartë në Laboratorë Mjekësorë në përputhje të plotë me kërkesat e tregut të punës në institucione shëndetësore publike e private.

Duke ofruar plane e programe mësimore të integruara (Bachelor dhe Master Profesional), cilësore, të qëndrueshme dhe të krahasueshme me sistemet arsimore europiane të arsimit të lartë, KU Logos synon t’u krijojë studentëve të saj një mundësi më të madhe të punësimit në tregun e punës kombëtar, rajonal e më gjerë.

GRUPI I VLERËSIMIT TË JASHTËM (GVJ)

Përbërja e GVJ: Bordi i Akteditimit dhe Agjencia e Sigurimit të Cilësisë në Arsimin e Lartë, vendosën: Prof. Dr. Etleva Refatllari dhe Dr. Nevila Heta ekspertë të jashtëm vlerësimi për këtë program studimi.

Gjatë gjithë procedurës, ekspertët e jashtëm të vlerësimit janë asistuar nga Koordinatori Teknik i ASCAL: Znj. Xhiliola Bixheku.

Më datë 11.06.2018 dërgohet në Institucion Draft Raporti i Vlerësimit të jashtëm i hartuar nga ekspertet e vlerësimit. Më datë 26.06.2018 Institucioni sjell në ASCAL komentet në lidhje me Draft – RVJ. Ekspertët e vlerësimit u njohën me këto komente dhe vendosën ti marrin në konsideratë dhe ti reflektojnë të gjitha në Raportin përfundimtar.

1. Misioni/Objektivat e programit të studimit

Pjesa përshkrimore

Terma reference: Qëllimet dhe objektivat e mësimdhënies dhe kërkimit shkencor, strategjitë afatshkurtra, afatmesme dhe afatgjata, ndjekja dhe përshtatja e objektivave dhe e qëllimeve me kohën, të dhëna të përgjithshme për IAL.

Misioni i programit të studimit të ciklit të dytë “Master Profesional” në Teknikë e Lartë në Laboratorë Mjekësorë është t’u japë studentëve që zotërojnë diplomë universitare Bachelor njohuri të thelluara teorike dhe praktike si dhe një trajnim të mirëfilltë profesional. Zgjerimi i njohurive të fituara në ciklin e parë të studimeve, i pajis studentët me kompetenca të përgjithshme dhe profesionale në fushën e laboratorëve mjekësorë duke i bërë konkurentë në tregun e punës në sektorët publikë e privatë. Programi ofron njohje më të plotë të aspekteve të ndryshme të mjekësisë laboratorike.

Objektivat në përgjithësi janë të qarta profesionalisht, të justifikueshme dhe të arritshme. Planet dhe programet mësimore janë në përputhje të plotë me kriteret e përcaktuara nga aktet ligjore dhe nënligjore në fuqi për arsimin e lartë si dhe kërkesat e sistemit të Bolonjës. Stafi akademik në përgjithësi ka kualifikimin e nevojshëm për të realizuar programin mësimor në këtë cikël studimi. Ambientet për organizimin e procesit mësimor janë bashkëkohore. Në funksion të programit janë tre laboratorë specifikë: mikrobiologjik, biokimik – klinik, histopatologjik, të cilët në strategjinë e institucionit parashikohet të plotësohen me aparatura të teknologjisë së avancuar. Bashkëpunimi me qendra mjekësore diagnostike publike dhe private krijon mundësi aftësimi praktik për studentët. Biblioteka ka një numër titujsh që i vijnë në ndihmë studentit për plotësimin e njohurive bazë të programit si dhe për zgjerimin e njohurive në fusha specifike gjatë punimit të temave të diplomës.

Pjesë e plotësimit të objektivave të programit “Master Profesional” në Teknikë e Lartë në Laboratorë Mjekësorë është hartimi dhe zbatimi i një strategjie afatshkurtër, afatmesëm dhe afatgjatë për përmirësimin e vazhdueshëm të programit.

Programi i studimit të ciklit të dytë “Master Profesional” në Teknikë e Lartë në Laboratorë Mjekësorë ka ekzistuar në KU Logos nga viti 2013 – 2014 sipas një strukture me 90 ECTS dhe kohëzgjatje 1.5 vite. Mbështetur në ndryshimet ligjore në fuqi, ky program është riorganizuar me një kohëzgjatje 1 vit dhe 60 ECTS. Ndryshimet konsistojnë në heqjen e dy lëndëve, Shkrim Akademik dhe Epidemiologji. Nocionet e Epidemiologjisë janë integruar në strukturën e lëndës së sëmundjeve

infektive, lëndë e formimit të përgjithshëm, ku ka ndryshuar raporti leksion/seminare në favor të leksioneve. Shkrimi akademik është lëndë e rëndësishme për një formim të thelluar shkencor por jo e detyrueshme për strukturën e një masteri me profil profesional. Po ashtu në funksion të përgatitjes më të mirë praktike, në programin e riorganizuar lënda e Kimisë Analitike është plotësuar me praktika laboratorike. Praktika profesionale në laboratorë jashtë KU Logos, shtrihet gjatë gjithë semestrit të dytë, një ditë në javë duke bërë që studenti krahas teorisë dhe praktikës laboratorike mësimore, të jetë në kontakt direkt me profesionin në laboratorë të rutinës mjekësore.

Vlerësimi sipas Standardeve

Standardi/Kriteret	Vlerësimi sipas standardeve
Standardi I.1 - Institucioni ofron programe studimesh në përputhje me misionin dhe qëllimin e tij.	
<p>Kriteri 3 Programet e studimeve hartohen në përputhje me misionin dhe qëllimin e institucionit;</p> <p>Kriteri 4 Programet e studimeve hartohen në përputhje me nevojat e tregut të punës;</p> <p>Kriteri 5 Programet e studimeve hartohen në përputhje me zhvillimin ekonomik të vendit;</p> <p>Kriteri 6 Programet e studimeve pasqyrojnë vullnetin e institucionit për ruajtjen e vlerave kulturore të kombit.</p>	<p>Kriteri 3 Programi i studimit në Masterin Profesional “Teknikë e Lartë në Laboratorë Mjekësorë” në përgjithësi, përmban elementët e domosdoshëm për të përmbushur misionin dhe për të realizuar objektivat për formimin e thelluar teorik – praktik të specialistëve “Teknikë e Lartë në Laboratorë Mjekësorë”</p> <p>Kriteri 4 Në Shqipëri nuk kemi studime të plota për nevojat e tregut të punës për specialistë, profesionistë në Laboratorin Mjekësor. Megjithatë janë disa fakte të rëndësishme që justifikojnë hapjen e një programi të tillë studimi:</p> <ul style="list-style-type: none"> – Në Shqipëri kryejnë aktivitet rreth 300 laboratorë në sistemin publik dhe privat – Sistemi teknologjik në përgjithësi, qoftë në laboratorë të vegjël, qoftë në laboratorë të mëdhenj është mjaft i avancuar (kërkesë e standartit për hapjen e një laboratorit); teknologjia e avancuar kërkon teknikë të lartë laboratorit me njohuri të thelluara teorike praktike. – Ka fusha të mjekësisë laboratorike si histopatologjia që kanë një përhapje jo të mirë në territorin Shqiptar dhe nuk sigurojnë mbulim të shërbimit në të gjithë vendin edhe për mungesë të specialistëve teknikë të laboratorit me njohuri të thelluara në këtë fushë. – KU Logos e mbështet punësimin e të diplomuarve dhe në nevojat e partnerëve për specialistë të fushës. <p>Mbështetur në këto argumenta mendojmë se hapja e këtij programi studimi është e justifikuar dhe në përputhje me nevojat e tregut aktual të punës për profesionistë të mirëkualifikuar në degën Teknik i Lartë Laboratori</p>

	<p>Kriteri 5 Zhvillimi social dhe ekonomik i vendit në përgjithësi dhe ambicia për integrim në hapësirën europiane, sot dhe në të ardhmen kërkon burime njerëzore të kualifikuara me një bazë të gjerë dhe të përshtatshme dijesh. Mendojmë se ky program studimi është në përputhje me strategjinë kombëtare të zhvillimit dhe integritit.</p> <p>Kriteri 6 KU Logos përgatit jo vetëm profesionistë të mjekësisë laboratorike apo të fushave të tjera të studimit por përgatit njëkohësisht qytetarë në shërbim të zhvillimit të përgjithshëm të vendit. Programi i studimeve të ciklit të dytë që ofron KU Logos siguron ruajtjen e vlerave kulturore kombëtare dhe për asnjë rast nuk bie ndesh me to.</p>
--	--

Standardi I.2 - Programet e studimeve janë në përputhje me strategjinë për zhvillim të institucionit.

<p>Kriteri 1 Programet e studimeve janë përshtatur me strategjinë për zhvillim të institucionit;</p>	<p>Kriteri 1 Institucioni deklaron në mënyrë të përmbledhur në planin strategjik të Departamentit “Teknikë të Lartë në Laborator Mjekësor” strategjitë e zhvillimit afatshkurtër (2017 – 2019), afatmesëm (2019 – 2021) dhe afatgjatë (2021 – 2024). Nga vizita në institucion dhe shqyrtimi i dokumentacioneve të vëna në dispozicion vlerësojmë si arritje të strategjisë afatshkurtër:</p> <ul style="list-style-type: none"> – rishikimin e syllabuseve të lëndëve dhe planeve mësimore me qëllim thellimin e njohurive profesionale dhe shkencore të fituara në programin Bachelor. – lidhjen e kontratave të bashkëpunimit me institucione ku studentët realizojnë praktikën dhe përgatisin tezën e diplomës. – Shtimin e bashkëpunimeve ndërinstytucionale për zhvillimin e aktiviteteve shkencore. <p>Është ecur më ngadalë në përmbushjen e synimit strategjik për ngritjen e strukturave didaktiko mësimore, të strukturave laboratorike me kapacitete më të mëdha diagnostikuese në përputhje me programin e studimit. Strategjia afatmesme dhe afatgjatë e SHLP Logos konsiston në:</p> <ul style="list-style-type: none"> – rishikimin e programit me synim përmirësimin, përditësimin me kërkesat e kohës sidomos për lëndët Histopatologji, Imunologji Klinike dhe Biologji Molekulare. – plotësimin në rritje të kushteve për zhvillimin e procesit mësimor në këto lëndë, me teknologji bashkëkohore (ngritje e laboratoreve).
---	---

	<p>– Shtimin e numrit të studentëve që zhvillojnë temat e diplomave në këto fusha. Programet e ofruara të studimit mund të konsiderohen të përshtatura mirë me këtë strategji të zhvillimit të institucionit.</p>
<p>Standardi I.3 - Programet e studimeve ofrohen në përputhje me aktet ligjore e nënligjore në fuqi.</p>	
<p>Kriteri 1 Përmbajtja e programeve të studimeve është në përputhje me kriteret e përcaktuara nga aktet ligjore dhe nënligjore në fuqi;</p> <p>Kriteri 2 Emërtimi i programit të studimit është në përputhje me nivelin e kualifikimit të arritur dhe të përcaktuar nga Korniza Shqiptare e Kualifikimit.</p>	<p>Kriteri 1 Struktura dhe përmbajtja e programit të studimit Master Profesional në përgjithësi është në përputhje me Ligjin e Arsimit të lartë Nr. 80/2015 si dhe me aktet nënligjore dhe udhëzimet që rrjedhin prej tij. Programi Master Profesional “Teknikë e Lartë në Laboratorë Mjekësorë” pranë KU Logos është i organizuar me kohë të plotë, me afat kohor prej 1 viti, në total me 60 kredite, nga të cilat praktikës profesionale, punimit të diplomës dhe provimit përfundimtar i shkojnë 11 kredite. Procesi mësimor në të dy semestrat është i organizuar në leksione, seminare dhe praktika laboratorike. Në semestrin e dytë, studentët ndjekin dhe praktikën profesionale pranë qendrave mjekësore ose klinikave publike dhe private me të cilat institucioni ka lidhur kontratë/marrëveshje bashkëpunimi. Studenti që ka plotësuar të gjitha kërkesat e planit dhe programit mësimor “Master Profesional” Teknikë e Lartë në Laboratorë Mjekësorë, ka kryer praktikën profesionale dhe ka mbrojtur temën e diplomës ose ka dhënë provimin përfundimtar, pajiset me diplomë universitare Master Profesional në “Teknikë e Lartë në Laboratorë Mjekësorë” të shoqëruar me suplementin e diplomës.</p> <p>Kriteri 2 Emërtimi i programit të studimit është në përputhje me nivelin 7 të kualifikimit të arritur dhe të përcaktuar nga Korniza Shqiptare e Kualifikimit.</p>
<p>Standardi I.11 - Institucioni harton një plan zhvillimi të programeve të studimeve, të rezultateve të mësimdhënies dhe të të nxënit.</p>	
<p>Kriteri 1 Institucioni harton një plan strategjik në nivel institucioni për zhvillimin dhe përmirësimin e programeve të studimeve;</p> <p>Kriteri 2 Institucioni harton një plan strategjik në nivel institucioni për përmirësimin e rezultateve të mësimdhënies dhe të të nxënit.</p>	<p>Kriteri 1 KU Logos ka një plan strategjik zhvillimi institucional të qartë ku të bien në sy kërkesat për përmirësim të vazhdueshëm të metodologjisë së mësimdhënies dhe modifikimin e përmirësimin e vazhdueshëm të mjediseve ku përgatiten këta specialistë të laboratorit mjekësor në përputhje me kërkesat e kohës.</p> <p>Kriteri 2 Institucioni ndërmerr vazhdimisht inisiativa për vlerësimin e nivelit të</p>

mësimdhënies dhe mësimnxënies. Strategjia e përmirësimit të mësimdhënies synon përfshirjen e studentit në diskutim aktiv të rasteve, përfshirjen aktive në seanca praktike, përdorimin e teknologjisë së avancuar në prezantime, leksione e praktika etj.

Konkluzionet e vlerësimit:

1. Programi i studimit të ciklit të dytë “Master Profesional” në Teknikë e Lartë në Laboratorë Mjekësorë është hartuar në përputhje të plotë me misionin dhe qëllimin e Institucionit dhe mbështet strategjinë për zhvillim të tij.
2. Institucioni për përmbushjen e misionit të tij është organizuar në përputhje të plotë me infrastrukturën ligjore dhe nënligjore në fuqi, duke ruajtur autonominë dhe lirinë akademike për aq sa e lejon ligji.
3. Programi i studimit Master Profesional në “Teknikë e Lartë në Laboratorë Mjekësorë” është i organizuar me kohë të plotë, me kohëzgjatje një vit akademik, me 60 kredite në total nga të cilët 11 kredite i përkasin praktikës profesionale, punimit të diplomës dhe/ose provimit përfundimtar.
4. Ky program studimi ka marrë në konsideratë nevojat e tregut të punës. Programi është në përputhje me strategjitë e zhvillimit të institucionit si dhe parashikon modifikime e përmirësime në përputhje me rezultatet e arritura dhe me kërkesat e zhvillimit të profesionit dhe sistemit laboratorik në Shqipëri.

Standardet janë përmbushur plotësisht

2. Struktura akademike e Fakultetit (Departamentit përgjegjës për programin e studimit)

Pjesa përshkrimore

Terma reference: përbërësit e njësisë dhe stafet e tyre, kompetencat, Baza e të dhënave të njësisë, freskimi i vazhdueshëm i saj dhe përgjegjësitë e mbajtjes dhe dhënies së informacionit

Fakulteti i Shkencave të Aplikuara i cili ofron edhe programin e studimit objekt të këtij raporti, përbëhet nga tre njësi bazë, përkatësisht dy departamente dhe një Qëndër e Kërkimit Shkencor (Departamenti Teknikë e Lartë në Laboratorë Mjekësorë; Departamenti Informatikë e Zbatuar dhe Qendra për Kërkim dhe Zhvillim Shkencor). Ky fakultet ofron programet e studimit të ciklit të parë “Bachelor” me kohë të plotë në:

- Teknikë e Lartë në Laboratorë Mjekësorë
- Informatikë e Zbatuar

Grupi i vlerësimit të jashtëm u njoh me organizimin hierarkik, organiogramën e fakultetit, stafet në përbërje të njësisve etj.

Vlerësimi i Treguesve të matshëm:

- Struktura akademike e Fakultetit (organigrama)

Programi i studimit Master Profesional në Teknikë e Lartë në Laboratorë Mjekësorë ofrohet nga Fakulteti i Shkencave të Aplikuara. Në dokumentacionin e vënë në dispozicionin tonë verifikohet organizimi hierarkik. Në krye të piramidës drejtuese është Senati i Universitetit dhe Rektori; në varësi të tyre është Dekani dhe Asambleja e Personelit Akademik. Fakulteti përbëhet nga dy departamente:

Departamenti “Teknikë e Lartë në Laboratorë Mjekësorë” dhe Departamenti “Informatikë e Zbatuar”. Fakulteti ka dhe një Qëndër Kërkimi. KU Logos ka ngritur dhe Bordin e Administrimit në varësinë e të cilit është dhe Administratori i Njesisë Kryesore.

☑ Personeli akademik për çdo njësi bazë: PAE, PAK, PA, titujt/gradat, (plotëso Tabelat ne aneks)

Pas vlerësimit të dosjes së bashku me dokumentat e aplikimit dhe vizitës së realizuar në institucion GVJ arriti të kishte të dhënat e nevojshme lidhur me personelin akademik efektiv, personelin akademik me kontratë dhe personelin administrativ. Gjatë verifikimit të tabelave të RVB u vunë re disa ndryshime në personelit akademik me kontratë të departamentit Teknikë e Lartë në Laboratorë Mjekësorë dhe gjithashtu pasaktësi në tabelat që paraqesin numrin e PAE, PKA, titujt/gradat etj. GVJ mori informacione të hollësishme dhe gjithashtu dokumentacion shtesë me tabela të përditësuara. Gjatë vlerësimit të RVJ dhe dokumentacionit GVJ evidentoi që Departamenti “Teknikë e Lartë në Laboratorë Mjekësorë” ka 7 anëtarë efektivë, si personel akademik, duke përmbushur kërkesat e ligjit 80/2015, neni 25, pika 4, për numrin minimal të anëtarëve.

Standardi/Kriteret	Vlerësimi sipas standardeve
Standardi II.2 - Institucioni organizohet në përputhje me aktet ligjore e nënligjore në fuqi, për përmbushjen e misionit të tij.	
<p>Kriteri 1 Institucioni organizohet në mënyrë që të përmbushë misionin e tij;</p> <p>Kriteri 2 Institucioni ka së paku dy Fakultete;</p> <p>Kriteri 3 Fakulteti organizohet në njësi bazë. Çdo fakultet ka, së paku, tri të tilla, nga të cilat dy departamente;</p> <p>Kriteri 4 Fakulteti ose Instituti i Kërkimit dhe Zhvillimit përbëhet nga, së paku, 3 njësi bazë me objektiva dhe mision të mirëpërcaktuar;</p> <p>Kriteri 5 Departamenti duhet të ketë në përbërje të tij të paktën 7 anëtarë efektivë si personel akademik, ndër të cilët të paktën 3 duhet të jenë me gradën shkencore “Doktor”.</p>	<p>Kriteri 1 Organizimi institucional dhe hierarkik është pjesërisht në përputhje me aktet ligjore e nënligjore në fuqi pasi ka 6 anëtarë efektivë, si personel akademik, duke mos përmbushur kërkesat e ligjit 80/2015, neni 25, pika 4, për numrin minimal prej 7 anëtarëve.</p> <p>Kriteri 2 KU “Logos” nga pikëpamja organizative përbëhet nga dy fakultete. Fakulteti i Shkencave të Aplikuara dhe Fakulteti Ekonomik.</p> <p>Kriteri 3 Secili Fakultet është organizuar me 3 njësi bazë. Fakulteti i Shkencave të Aplikuara përbëhet nga tre njësi bazë: dy departamente; Departamenti Teknikë e Lartë në Laboratorë Mjekësor, Departamenti i Informatikës së Zbatuar dhe një Qëndër Kërkimi. Fakulteti Ekonomik përbëhet nga tre njësi bazë: tre departamente; Departamenti Financë-Kontabilitet, Departamenti Menaxhim Turizmi, Departamenti Menaxhim Biznesi.</p> <p>Kriteri 4 Fakulteti i Shkencave të Aplikuara përbëhet nga 3 njësi bazë ku Departamenti Teknikë e Lartë në Laboratorë Mjekësor si përgjegjës i Programit Master Profesional në Teknikë i Lartë në Laboratorë Mjekësor, ka një mision dhe objektiva të qarta dhe të mirëpërcaktuara.</p> <p>Kriteri 5 Departamenti “Teknikë e Lartë në Laboratorë Mjekësorë” ka 7 anëtarë efektivë, si personel akademik, ndër të cilët referuar</p>

	<p>dokumentacionit të paraqitur dhe vizitës në vend:</p> <ul style="list-style-type: none"> - 1 profesor - 3 doktor shkencash - 3 me diplomë Master <p>Departamenti ka numrin minimal të anëtarëve duke përmbushur kërkesat e ligjit 80/2015, neni 25, pika 4.</p>
<p>Standardi II.3 - Njësitë e institucionit angazhohen drejtpërdrejt dhe me përkushtim për realizimin e programeve të studimeve.</p>	
<p>Kriteri 1 Njësitë bazë dhe kryesore janë të ndërgjegjshme për përgjegjësitë që kanë për realizimin e programeve të studimeve;</p> <p>Kriteri 2 Njësitë bazë dhe kryesore përfshihen në procesin e rekrutimit të personelit akademik të nevojshëm dhe në vlerësimin e tij.</p>	<p>Kriteri 1 Stafit akademik i njësisë bazë (Departamenti) dhe asaj kryesore (Fakultetit) punon me përkushtim dhe me ndjenjë të lartë përgjegjësie për realizimin e programit të studimit. Kjo ndjenjë përgjegjësie e përkushtimi u vu re dhe në diskutimin individual me anëtarët e stafit akademik efektiv dhe me kontratë të pranishëm gjatë vizitës sonë.</p> <p>Kriteri 2 Rekrutimi i stafit akademik bëhet në përputhje të plotë me kriteret e përcaktuara në Ligjin e Arsimit të Lartë, në Statut dhe Rregulloren e KU “Logos” ku njësitë bazë dhe kryesore përfshihen në procesin e rekrutimit të personelit akademik të nevojshëm si dhe në vlerësimin e tij. Gjatë vizitës në institucion na u vu në dispozicion skema dhe procedura e rekrutimit të stafit akademik. Nga dokumentacioni i vënë në dispozicion dhe takimet që patëm me titullarët e Institucioni, u vu re që, procedura e rekrutimit ishte transparente. Institucioni bënte publikimin e kriteret në faqen e tij në internet në bazë të nevojave që kishte. Më pas ngrihej një komision i cili intervistonte dhe vlerësonte kandidatin.</p>
<p><u>Konkluzionet e vlerësimit:</u></p> <ol style="list-style-type: none"> 1. Struktura akademike e Fakultetit të Shkencave të Aplikuara është organizuar në përputhje të plotë me infrastrukturën ligjore dhe nënligjore në fuqi. Ai përbëhet nga tre njësi bazë: dy departamente: Departamenti Teknikë e Lartë në Laboratorë Mjekësor, Departamenti Informatikë e Zbatuar dhe një Qëndër Kërkimi dhe Zhvillimi Shkencor. 2. Departamenti Teknikë e Lartë në Laboratorë Mjekësor, ka në përbërje të tij 7 (gjashtë) anëtarë efektiv nga të cilët 1 (një) me titull professor, 3 (tre) doktorë shkencash dhe 3(tre) me diplomë Master nga të cilët 2(dy) në proces doktorature. Në Departamentin Teknikë e Lartë në Laboratorë Mjekësor plotësohet numri minimal i anëtarëve efektive akademike, sipas kërkesave e ligjit 80/2015. 3. Personeli akademik me kontratë është përzgjedhur në shumicën e rasteve mes specialistëve me eksperiencë e kualifikim në fushat specifike që mbulon programi i studimit. 4. Departamenti Informatikë e Zbatuar ka në përbërje të tij 7 (shtatë) anëtarë efektiv. 5. Rekrutimi i personelit akademik bëhet në përputhje me aktet ligjore dhe nënligjore në fuqi, me Statutin dhe rregulloren e miratuar nga Senati. Institucioni mban një bazë të dhënash për stafin akademik. Personeli akademik i ka të përcaktuara qartë përgjegjësitë për realizimin e programit të studimit dhe është i ndërgjegjshëm në përmbushjen e detyrimeve ndaj Institucionit. 	

3. Personeli akademik dhe personeli mbështetës për programin e studimit

Pjesa përshkrimore

Terma reference: Të dhëna për kualifikimin e Personelit akademik, ndarja e tij në Personel Akademik Efektiv (PAE) dhe Personel Akademik me Kontratë (PAK), Personel Administrativ (PA), raporti PAE/PAK, raportet: Personel akademik/Personel administrativ/student; nevojat për Personel akademik/ administrativ, shpërndarja e ngarkesës për personelin akademik, marrëdhëniet me strukturat e tjera jashtë kohës së punësimit, kriteret e rekrutimit të personelit akademik, etj.

Pas njohjes me dosjen e aplikimit dhe vizitës së kryer në ambientet e KU “Logos”, grupi i vlerësimit të jashtëm arriti të kishte të dhënat e nevojshme lidhur me personelin akademik, personelin administrativ, shpërndarjen e ngarkesave mësimore mes personelit efektiv dhe personelit me kontratë për programin e Masterit Profesional në Teknik i Lartë i Laboratorit Mjekësor. Raporti PAE/PAK është **67% : 33%**, theksojmë se ky raport ka të bëjë me numrin e personelit të angazhuar, ndërsa në referencë të krediteve, PAE mbulon 70% të tyre dhe PAK 30%, duke ruajtur raportin 70% : 30%. Raporti Personel akademik/personel administrativ është **82% : 18%** dhe raporti PAE/student është **1:15**. Në shpërndarjen e ngarkesës mësimore vihet re **mbingarkesë në orë mësimore në një pjesë të stafin akademik dhe një numër i lartë lëndësh të cilat mbulohen nga një pedagog**. Ne u njohëm gjithashtu me mënyrat e rekrutimit të personelit dhe tipin e kontratës për të dy kategoritë e punonjësve akademike (PAE dhe PAK).

Vlerësimi i Treguesve të matshëm:

- Numri i Personelit Akademik Efektiv (PAE) dhe Personelit Akademik me Kontratë (PAK), titujt/gradat,

Në programin e studimit “Master Profesional në **Teknikë e Lartë në Laboratorë Mjekësor**” është angazhuar drejtpërdrejt Departamenti “**Teknikë e Lartë në Laboratorë Mjekësor**” i Fakultetit të Shkencave të Aplikuara me 4 (katër) anëtarë personel akademik efektiv, Qendra e Kërkimit Shkencor me 3 (tre) anëtarë personel akademik efektiv. Për realizimin e programit janë angazhuar dhe 3 (tre) anëtarë personel akademik me kontratë si dhe personeli ndihmës akademik 2 (dy).

Në tabelat e RVB kishte **paqartësi dhe pasaktësi** në numrin e pedagogëve efektivë dhe me kontratë dhe në raportet përkatëse. Gjatë vizitës në institucion GVJ mori informacion të detajuar në lidhje me këto pasaktësi dhe gjithashtu dokumentacion dhe tabela të përditësuara të cilat na ndihmuan për hartimin e këtij raporti.

- Të dhënat sipas kualifikimit dhe Raportet midis tyre (Plotëso Tabelat ne aneks)

Në programin e studimit “Master Profesional në **Teknikë e Lartë në Laboratorë Mjekësor**” janë të angazhuar: si PAE 2 (dy) Profesore, 1 (një) Profesor As, 4 (katër) doktor shkencash. Gjithashtu si PAK, janë të angazhuar 2 (dy) Profesor As. dhe 1(një) Doktor shkencash. Në tabelat e RVB kishte pasaktësi për të cilat u diskutua dhe tabelat u ndryshuan në dokumentacionin shtesë.

Personeli akademik që mbulon programin “Master Profesional” **përbëhet kryesisht nga pedagogë me eksperiencë dhe kualifikim të lartë profesional në fushat përkatëse.** Gjatë shqyrtimit të RVJ dhe vizitës në IAL u evidentua që **në dy raste, fusha e ekspertizës së pedagogut nuk përputhet me syllabusin e lëndës në të cilën është titullar (përkatësisht Lënda: Biokimi Klinike e Avancuar dhe Analizë Klinike e Avancuar e Gjakut dhe lëngjeve Biologjike). Rekomandojmë që këto lëndë në të ardhmen të mbulohen me staf akademik që i përket fushës përkatëse së ekspertizës.**

- Të dhënat sipas seksit. Të dhëna sipas moshës së personelit (Plotëso Tabelat ne aneks)

Në personelin akademik efektiv të departamentit “**Teknikë e Lartë në Laboratorë Mjekësor**” raporti meshkuj/femra është 2/4. Ndërsa në PAE të angazhuar në programin e studimit raporti është ¾. Vihet re një numër i lartë i femravë të përfshira në proceset akademike në përgjithësi dhe vecanërisht në degët e mjekësisë laboratorikë.

Mosha e personelit akademik efektiv, **vihet re të jete e lartë në këtë program studimi** ,4(katër) nga 7(shtatë) pedagogë janë të moshës mbi 66 vjec, ndërsa në personelin me kontratë grup mosha predominante është 45-55 vjec.

- Kontratat e punës, njohja me detyrat dhe të drejtat

Grupi i punës u njoh me modelet e kontratave të punës, me procedurat e rekrutimit të stafit etj. Në diskutim me pedagogët u konstatua se ata njihen paraprakisht me të drejtat dhe detyrimet që rrjedhin nga lidhja e kontratës së punës. Gjatë vizitës në institucion GVJ verifikoi kontratat e punës për të gjithë stafit akademik efektiv dhe me kontratë.

- Cilësia e stafit ndihmës/ administrativ për çdo njësi bazë
- Grupi i vlerësimit u njoh me stafin ndihmës administrativ dhe ndihmës mësimor dhe konstatoi se ky staf i përmbush kriteret e kualifikimit dhe profesionalizmit që kërkohet në këto pozicione pune.

- Dokumentacioni përkatës i marrë në vizitat në institucion

Gjatë vizitës në institucion konsultuam dhe disa dokumentacione të tjera si dosje të personelit akademik efektiv dhe me kontratë, dokumentacione të rekrutimit të pedagogëve të rinj, skemen e procedurës së rekrutimit të pedagogeve, dokumente të shpërndarjes së ngarkesës mësimore të stafit akademik etj.

Vlerësimi sipas Standardeve

Standardi/Kriteret	Vlerësimi sipas standardeve
Standardi II.1 - Personeli akademik, ndihmës mësimor-shkencor dhe administrativ angazhohen për përmbushjen e objektivave të programeve të studimeve.	
Kriteri 1 Personeli akademik, ndihmës mësimor-shkencor dhe administrativ i institucionit angazhohen në përputhje me objektivat e programeve të studimeve dhe për arritjen e tyre;	Kriteri 1 Personeli akademik, ndihmës mësimor-shkencor dhe administrativ i institucionit është rekrutuar dhe përzgjedhur në përputhje me standartet e kërkuara për të përmbushur objektivat e studimit të programit Master Profesional në Teknik i Lartë i Laboratorit Mjekësor. Kriteri 2 Pozicionimi i personelit akademik,

<p>Kriteri 2 Personeli akademik, ndihmës mësimor-shkencor dhe administrativ i institucionit angazhohen në përputhje me strategjinë për zhvillim të institucionit.</p>	<p>ndihmës mësimor-shkencor dhe administrativ të institucionit është në përputhje me strategjinë e deklaruar për zhvillimin e institucionit;</p>
<p>Standardi II.4 - Personeli akademik angazhohet në hartimin dhe zbatimin e politikave të zhvillimit të institucionit.</p>	
<p>Kriteri 1 Personeli akademik luan rol kryesor në hartimin e kurrikulës dhe në vendimet institucionale që i përkasin organizimit të programeve të studimeve;</p> <p>Kriteri 2 Rekrutimi i personelit të ri dhe përcaktimi i ngarkesës mësimore bëhet në përputhje me aktet ligjore dhe nënligjore në fuqi.</p>	<p>Kriteri 1 Gjatë vizitës së grupit të punës në institucion u konstatua se personeli akademik ka luajtur rol të rëndësishëm në hartimin e kurrikulës, dhe në organizimin e programeve të studimit. Vendimet institucionale për organizimin e programit të studimit mbështeten edhe në sugjerimet e stafit akademik.</p> <p>Ndryshimet e Programit të studimit të ciklit të dytë “Master Profesional” në Teknikë e Lartë në Laboratorë Mjekësorë konsistojnë në heqjen e dy lëndëve, shkrim akademik dhe epidemiologji. Nocionet e epidemiologjisë janë integruar në strukturën e lëndës së sëmundjeve infektive, lëndë e formimit të përgjithshëm, ku ka ndryshuar raporti leksion/seminare në favor të leksioneve. Shkrimi akademik është lëndë e rëndësishme për një formim të thelluar shkencor por jo e detyrueshme për strukturën e një masteri me profil profesional. Po ashtu në funksion të përgatitjes më të mirë praktike, në programin e riorganizuar lënda e Kimisë Analitike është plotësuar me praktika laboratorike. Praktika profesionale në laboratorë jashtë KU Logos, shtrihet gjatë gjithë semestrit të dytë, një ditë në javë duke bërë që studenti krahas teorisë dhe praktikës laboratorike mësimore, të jetë në kontakt direkt me profesionin në laboratorë të rutinës mjekësore.</p> <p>Kriteri 2 Për rekrutimin e stafit akademik efektiv institucioni i përmbahet akteve ligjore dhe nënligjore në fuqi dhe gjithashtu Statutit dhe Rregullores përkatëse. Ngarkesa mësimore e një pjese të stafit akademik është më e lartë se normat e përcaktuara.</p>
<p>Standardi III.1 - Institucioni ndjek procedura ligjore dhe transparente për rekrutimin dhe vlerësimin e personelit.</p>	
<p>Kriteri 1 Institucioni ndjek procedura ligjore dhe transparente për rekrutimin e personelit në përputhje me statutin dhe rregulloren;</p> <p>Kriteri 2 Personeli akademik i punësuar me kohë të plotë në programet e studimeve të ciklit të dytë dhe në programet e integruara të studimeve të ciklit të dytë përbën së paku 70% të personelit akademik të angazhuar për</p>	<p>Kriteri 1 Institucioni ndjek procedura ligjore dhe transparente për rekrutimin e personelit. Procedurat e rekrutimit të personelit janë në përputhje me kërkesat dhe kriteret e sanksionuara në statutin dhe rregulloren e institucionit.</p> <p>Kriteri 2 Megjithë përmirësimin e strukturës pas reformës së arsimit të lartë, stafi akademik i punësuar me kohë të plotë përbën 67% të personelit akademik të angazhuar për realizimin e programit të studimit Master Profesional në Teknikë</p>

<p>realizimin e programeve respektive të studimeve;</p> <p>Kriteri 3 Institucioni ndjek procedura ligjore dhe transparente të vlerësimit të personelit;</p> <p>Kriteri 4 Institucioni mban një bazë të dhënash të raporteve të rekrutimit të personelit, të njoftimeve për vende vakante, etj.</p>	<p>i Lartë i Laboratorit Mjekësor, i cili mbulon 70% të krediteve të programit të studimit Master Profesional Teknikë e Lartë në Laboratorë Mjekësor</p> <p>Kriteri 3 Në statutin dhe rregulloren e institucionit janë përcaktuar procedurat ligjore për vlerësimin e personelit. Këto procedura janë transparente dhe përfshijnë: realizimin e ngarkesës mësimore të normuar, punën kërkimore-shkencore, kualifikimin, pjesmarrjen në konferenca dhe referimin në to, planin e botimeve etj.</p> <p>Kriteri 4 Institucioni disponon një bazë të dhënash mbi raportet e rekrutimit të personelit (dosje individuale), njoftimeve për vende të lira pune etj.</p>
<p>Standardi III.2 - Personeli akademik (me grada shkencore dhe tituj akademikë) mbulon nevojat e institucionit dhe i ka të përcaktuara qartë përgjegjësitë.</p>	
<p>Kriteri 1 Përgjegjësi i programit ka të paktën titullin “Profesor i asociuar” ose, gradën shkencore “Doktor” (“PHD”) të fituar pranë universiteteve perëndimore dhe përvojë akademike në këto universitete;</p> <p>Kriteri 2 Titullari i lëndës/modulit në programet e studimeve “Master i Shkencave” ka të paktën gradën shkencore “Doktor”;</p> <p>Kriteri 3 Titullari dhe pedagogët e lëndës/modulit në programet e studimeve “Master profesional” ka të paktën gradën shkencore “Doktor” ose, diplomën “Master Profesional” ose “Master Shkencash” dhe një përvojë profesionale së paku 5-vjeçare në profesionin në të cilin ofrohet ky program studimi;</p> <p>Kriteri 4 Rektori, zv/rektori, drejtori dhe zv/drejtori i qendrës ndëruniversitare, dekani, zv/dekani, drejtori, përgjegjësi i departamentit, përgjegjësi i shërbimit, përgjegjësi i programit janë të punësuar me kohë të plotë në institucionin që ofron programin e studimeve;</p> <p>Kriteri 5 Institucioni siguron personel të mjaftueshëm për udhëheqjen dhe mbikëqyrjen e praktikave profesionale.</p>	<p>Kriteri 1 Përgjegjësi i programit “Master Profesional Teknikë e Lartë në Laboratorë Mjekësor” është me gradën shkencore “Doktor” (“PHD”) të fituar jashtë vendit, në universitetet perëndimor.</p> <p>Kriteri 2 N/A</p> <p>Kriteri 3 Pedagogët e lëndëve/moduleve në programin e studimit “Master Profesional në Teknik i Lartë Laboratorësh Mjekësorë” mbajnë titullin Profesor, Profesor i Asociuar dhe gradën Doktor.</p> <p>Kriteri 4 Rektori, dekani, përgjegjësi i departamentit, përgjegjësi i programit të studimit janë të punësuar me kohë të plotë në institucion.</p> <p>Kriteri 5 Institucioni siguron personel të mjaftueshëm për udhëheqjen dhe mbikëqyrjen e praktikave profesionale. Qendra e kërkimit shkencor ka përcaktuar procedura të sakta për organizimin e praktikës mësimore. Hartimi i programit të praktikës dhe vlerësimi i saj realizohen nga drejtuesi i praktikës pranë vendit ku ajo realizohet dhe firmoset dhe nga pedagogu përgjegjës</p>

Standardi III.5 - Studentët që ndjekin programet e studimeve të ciklit të dytë “Master i Shkencave” apo programet e integruara të studimeve të ciklit të dytë kanë udhëheqës për tezën.	
<p>Kriteri 1 Studentët që ndjekin këto programe studimesh kanë një udhëheqës për punën kërkimore dhe tezën që përgatisin për marrjen e diplomës në përfundim të studimeve të këtij cikli;</p> <p>Kriteri 2 Udhëheqësi ka të paktën gradën shkencore “Doktor”;</p> <p>Kriteri 3 Udhëheqësi nuk mbikëqyr më shumë se 5 (pesë) studentë njëkohësisht për temat me karakter kërkimor të aplikuar (si ato të ofruara në programet e studimeve në fushat e shkencave të natyrës, shkencave mjekësore, etj.) dhe më shumë se 10 (dhjetë) studentë njëkohësisht për temat e ofruara në programet e studimeve në fushat e shkencave shoqërore e humane.</p>	<p>Kriteri 1 Studentët që ndjekin programin “Master Profesional” në Teknikë i Lartë Laboratorësh Mjekësorë drejtohen nga një udhëheqës shkencor për punën kërkimore dhe përgatitjen e mikrotezës për marrjen e diplomës në përfundim të studimeve të këtij cikli.</p> <p>Kriteri 2 Udhëheqësit e studentëve të programit “Master Profesional” në Teknikë i Lartë Laboratorësh Mjekësorë mbajnë gradën shkencore “Doktor”.</p> <p>Kriteri 3 Gjatë vizitës në vend dhe dokumentacionit të vënë në dispozicion nga IAL, konstatuam se udhëheqësit shkencor mbikëqyrin nga një (1) student për përgatitjen e mikrotezës, kjo për arsye se vërtëm një numër i vogël i studentëve mbronin temë diplome. Gjatë vizitës dhe takimeve të realizuara na u tha se studentët me mesatare mbi 8 bënin mbrojtje të temës së diplomës, kurse të tjerët jepnin një provim formimi.</p>
Standardi III.6 - Fusha studimore-kërkimore në të cilën është specializuar udhëheqësi është në përputhje me fushën studimore në të cilën ofrohet programi i studimit dhe është parashikuar të përgatitet teza.	
<p>Kriteri 1 Fusha studimore-kërkimore në të cilën është specializuar udhëheqësi është në përputhje me fushën studimore në të cilën ofrohet programi i studimit.</p> <p>Kriteri 2 Udhëheqësi ka njohuri të avancuara teorike dhe aftësi të veçanta kërkimore në fushën në të cilën ofrohet programi i studimeve dhe në të cilën është parashikuar të hartohet teza.</p>	<p>Kriteri 1 Nisur nga të dhënat e CV të personelit akademik të institucionit mund të themi se fushat kërkimore-shkencore të udhëheqësve janë në përputhje me fushën studimore në të cilën ofrohet programi i studimit “Master Profesional”</p> <p>Kriteri 2 Përvoja akademike në fushën e mjekësisë dhe grada shkencore e udhëheqësit garantojnë aftësitë kërkimore në fushën në të cilën ofrohet programi i studimit dhe në të cilën parashikohet të hartohet teza.</p>
Standardi III.7 - Institucioni angazhon personel ndihmës mësimor-shkencor dhe administrativ për përmbushjen e misionit të tij.	
<p>Kriteri 1 Institucioni dëshmon një angazhim optimal të personelit ndihmës mësimor-shkencor për realizimin e orëve laboratorike dhe për mirëmbajtjen e laboratorëve e mjediseve shkollore;</p> <p>Kriteri 2 Institucioni dëshmon një përdorim optimal të burimeve njerëzore për përmbushjen e objektivave të programeve të studimeve të ciklit të dytë.</p>	<p>Kriteri 1 Institucioni dëshmon angazhim serioz të personelit ndihmës mësimor-shkencor për realizimin e orëve laboratorike dhe mirëmbajtjen e laboratoreve e mjediseve shkollore; kjo u konstatua qartë nga grupi i vlerësimit gjatë vizitës në institucion dhe nga shqyrtimi i dokumentacionit shkencor.</p> <p>Kriteri 2 Alokimi i burimeve njerëzore brenda institucionit është realizuar në mënyrë të kënaqshme.</p>

Standardi III.8 - Personeli akademik realizon ngarkesën mësimore të përcaktuar në aktet ligjore e nënligjore në fuqi.	
<p>Kriteri 1 Personeli akademik realizon ngarkesën mësimore të përcaktuar në aktet ligjore e nënligjore në fuqi;</p> <p>Kriteri 2 Ngarkesa mësimore e zhvilluar nga personeli akademik në programet e studimeve të ciklit të dytë dhe në programet e integruara të studimeve të ciklit të dytë dhe organizimi e drejtimi i tyre, vlerësohen me orë mësimore.</p>	<p>Kriteri 1 Personeli akademik realizon ngarkesën mësimore të përcaktuar në aktet ligjore e nënligjore në fuqi. Sipas RVJ dhe verifikimit në vend u evidentua që IAL zbaton Udhëzimin nr. 20 datë 9.05.2008 “Për veprimtarinë e personelit akademik në Institucionet Publike të Arsimit të Lartë” pamvarësisht se ky udhëzim i takon instucione publike të arsimit të lartë dhe në këtë rast nuk është i detyrueshëm për tu zbatuar.</p> <p>Kriteri 2 Vlerësimi i ngarkesës mësimore bëhet sipas Udhëzimit nr. 20 më sipër ku ngarkesa e normuar vjetore, në orë mësimore ku përfshihen: leksione, seminare, punë laboratorike. Në shpërndarjen e ngarkesës mësimore vihet re një shpërndarje jo uniforme duke shkaktuar mbingarkesë në orë mësimore në një pjesë të stafin akademik.</p>
Standardi III.9 - Institucioni disponon një bazë të dhënash për personelin e tij.	
<p>Kriteri 1 Institucioni disponon një bazë të dhënash të hollësishme për anëtarët e personelit akademik të përfshirë në program dhe të personit përgjegjës për organizimin e programit të studimit;</p> <p>Kriteri 2 Institucioni disponon për secilin semestër listën e plotë të personelit akademik, të personelit ndihmës mësimor-shkencor dhe personelit administrativ;</p> <p>Kriteri 3 Institucioni përcakton dhe publikon kriteret dhe procedurat për rekrutimin e personelit akademik.</p>	<p>Kriteri 1 Institucioni disponon një bazë të dhënash të hollësishme për anëtarët e personelit akademik efektiv dhe me kontratë të përfshirë në program dhe të personit përgjegjës për organizimin e programit të studimit. Kjo bazë të dhënash gjendet pranë zyrës së Burimeve Njerëzore në dosjet personale të stafit akademik. (dokumentacioni u verifikua).</p> <p>Kriteri 2 Institucioni (koordinatori i programit) disponon për secilin semestër listën e plotë të personelit akademik, të personelit ndihmës mësimor-shkencor dhe personelit administrative</p> <p>Kriteri 3 Institucioni përcakton dhe publikon në median e shkruar dhe elektronike, kriteret dhe procedurat për rekrutimin e personelit akademik, procedura u verifikua nga dokumentacioni që na u vu në dispozicion dhe nga takimet e realizuara me titullarët.</p>
<p><u>Konkluzionet e vlerësimit:</u></p> <ol style="list-style-type: none"> 1. Personeli akademik ndihmës dhe administrativ është i angazhuar dhe punon me përkushtim për përmbushjen e objektivave të programit të studimit “Master Profesional” në Teknikë i Lartë Laboratorësh Mjekësorë. Ai plotëson përgjithësisht detyrimet që rrjedhin nga aktet ligjore dhe nënligjore në fuqi. Institucioni disponon një bazë të dhënash përfshirë dosjet individuale të tyre (CV, Informacioni mbi diplomat, kërkimin shkencor etj.) si dhe për shpërndarjen e ngarkesës mësimore vjetore. 2. Drejtuesi i programit përmbush kriterin gradës shkencore Doktor të fituar në universitete perëndimore. 3. Shpërndarja e ngarkesës mësimore nuk është bërë në mënyrë të standartizuar dhe një pjesë e pedagoqeve kanë një ngarkesë të lartë në orë mësimore dhe në numër lëndësh. 4. Drejtimi i lëndëve e moduleve realizohet nga titullarë me të paktën gradën shkencore Doktor. 	

5. Në shperndarjen e ngarkesës mësimore vihet re **mbingarkesë në orë mësimore në një pjesë të stafin akademik dhe një numër i lartë lëndësh.**
6. Në dy raste, fusha e ekspertizës së pedagogut nuk përputhet me syllabusin e lëndës në të cilën është titullar duke ndikuar direkt në cilësinë e mësimdhënies. **Rekomandojmë që këto lëndë në të ardhmen të mbulohen me staf akademik që i përket fushës përkatëse së ekspertizës.**
7. Çdo student i programit “Master Profesional” në Teknikë i Lartë Laboratorësh Mjekësorë bashkëpunon me udhëheqësin e tij shkencor për përgatitjen e mikrotezës, ku kualifikimi i udhëheqësit përputhet me fushën e mjekësisë në të cilën hulumton studentin.

Standardet janë përmbushur kryesisht

4. Infrastruktura në funksion të programit të studimit, logjistika dhe shërbime të tjera ndaj komunitetit

Pjesa përshkrimore

Terma reference: mjediset, infrastruktura, teknologjitë e informacionit, biblioteka, shërbime të tjera për studentët, residencat.

Mjediset, infrastruktura, teknologjia e informacionit, biblioteka, shërbimet për studentët janë të përshtatshme dhe të mjaftueshme për zhvillimin e një procesi normal mësimor të nivelit Master Profesional.

Vlerësimi i Treguesve të matshëm:

Mjediset për Programin e studimit

Mjediset ku zhvillohet programi i studimit u verifikuan gjatë vizitës së grupit të vlerësimit në institucion. Një pjesë e mjediseve si biblioteka, salla për aktivitete promovuese, palestra etj. i shërbejnë studentëve të të dy fakulteteve. Një numër ambientesh të tjera na u referuan në proces kompletimi (4 salla leksionesh, 4 ambiente për seminare dhe 1 ambient ndihmës/clodhës për studentë, 2 zyra për personelin dhe 1 bibliotekë). Në dokumentacionin shoqërues të RVB (Aneksi 4.1) është paraqitur tabela përmbledhëse e ndarjes dhe organizimit të ambienteve mësimore dhe ndihmëse të KU Logos që u verifikuan. Dokumentet shoqëruese janë planimetritë e detajuara të ambienteve, kontrata e huapërdorjes së ambienteve, akt – miratimi higjienosantar dhe Certifikata për mbrojtjen nga zjarri dhe shpëtimin. Në tabelën 7 të RVB janë përmbledhur të detajuara mjediset për Fakultetin përgjegjës për programin e studimit si më poshtë:

- Salla për leksione – 4; njëra nga sallat ishte e paisur me sistem multimedia, në sallat e tjera Fakulteti /Departamenti vë në dispozicion të pedagogëve videoprojektorë portabël.
- Klasa për seminare – 2
- Salla për aktivitete promovuese – 1
- Salla për praktikë lëndore/ profesionale
- Laboratorë për lëndët – 3 laboratorë për lëndët profesionale:
 - Biokimi klinike – hematologji
 - Mikrobiologji
 - Histopatologji

Laboratorët **në përgjithësi** janë të pajisur me teknologji dhe mjete didaktike.

- Laboratorë informatike - 3
- Salla për bibliotekë – 1 sallë biblioteke e paisur dhe me sistem të bibliotekës online
- Mjedis për fotokopjime, librari etj
- Zyrë informacioni për studentët – 1 zyrë informimi
- Nyje hidrosanitare - 4 të tilla për studentët

Mjediset për stafin:

Institucioni ofron ambiente pune për personelin akademik dhe për administratën (tabela 7 e RVB). Gjatë vizitës në institucion verifikuam se mjediset në dispozicion të stafit akademik, atij ndihmës mësimor-shkencor dhe administrativ janë të mjaftueshme, të paisura në mënyrë të përshtatshme për zhvillimin e aktivitetit normal .

- Mjedise për Dekanin/ Zv. Dekanin/kancelarin – 2
- Zyra për sekretarinë mësimore – 1
- Zyra për departamentet/qëndrat kërkimore – 3
- Zyra për personelin akademik – 3
- Zyrë për financën – 1
- Mjedis për stafin e shërbimit – 1
- Nyje hidrosanitare për personelin – 8

Gjatë vizitës në institucion konstatuam se të dhënat e dosjes së vetëvlerësimit përputhen me gjendjen e konstatuar të ambienteve në dispozicion të programit të studimit si dhe në dispozicion të stafit. U vizituan të gjitha ambientet në dispozicion të programit të studimit Master Profesional në Teknikë e lartë në Laboratorë Mjekësorë. Në dokumentin e strategjisë, për një pjesë të aparaturave përdoret shprehja “Pjesërisht në funksion”. Konstatuam gjatë vizitës se ky term lidhej më shumë me disponibilitetin në reagentë se me gjendjen fizike të tyre.

Vlerësimi sipas Standardeve

Standardi/Kriteret	Vlerësimi sipas standardeve
Standardi II.5 - Institucioni siguron infrastrukturën e nevojshme për realizimin e programeve të studimeve të ciklit të dytë dhe të programeve të integruara të studimeve të ciklit të dytë që ofron.	
<p>Kriteri 1 Institucioni ka një vendndodhje të përhershme, që nënkupton mjedis qendror administrativ dhe mjedis ku zhvillohet veprimtaria mësimore;</p> <p>Kriteri 2 Këto mjedise janë në dispozicion të institucionit për jo më pak se 6 vjet;</p> <p>Kriteri 3 Nëse programi i studimit ofrohet në më shumë se një godinë, institucioni siguron menaxhim efikas dhe kontroll të vazhdueshëm për arritjen e standardeve dhe zbatimin e politikave arsimore të hartuara për realizimin e programeve të studimeve që ofron;</p>	<p>Kriteri 1 Institucioni ka një vendndodhje të përhershme me adresë në rrugën “Dritan Hoxha” pallatet Komfort (mbi NBG) Tiranë, që nënkupton mjedis qendror administrativ dhe mjedis ku zhvillohet veprimtaria mësimore.</p> <p>Kriteri 2 Këto mjedise janë në dispozicion të institucionit dhe janë pronë e KOASH (Kisha Orthodhokse Autoqefale e Shqipërisë dhënë në huapërdorje ShLP”Logos” që në vitin 2008 për shfrytëzim pa afat.</p> <p>Kriteri 3 dhe 4 Programi i studimit ofrohet në një godinë. Institucioni garanton kapacitete laboratorike përgjithësisht të mjaftueshme për kryerjen e seancave laboratorike sipas programit të syllabuseve në modulet mësimore. Gjatë vizitës</p>

<p>Kriteri 4 Institucioni garanton kapacitete dhe mjedise të mjaftueshme për realizimin e praktikave profesionale të parashikuara për realizimin e programeve të studimeve në fushat e shëndetësisë, veterinarisë, bujqësisë, shkencave teknike, etj.</p>	<p>konstatuam se, baza materiale ekzistente është parashikuar për t'u plotësuar në dokumentin strategjik të institucionit. Është konkretizuar blerja e reagenteve. Për teknologjitë e reja mësimi plotësohet nga praktika profesionale që zhvillohet në laboratorë dhe institucione shëndetësore publike ose private me të cilët KU Logos ka lidhur marrëveshje bashkëpunimi.</p>
<p>Standardi V. 1- Institucioni vë në dispozicion të studentëve bibliotekën e tij.</p>	
<p>Kriteri 1 Institucioni siguron tekste mësimore cilësore dhe literaturë ndihmëse të mjaftueshme dhe bashkëkohore;</p> <p>Kriteri 2 Në bibliotekë ka literaturë të mjaftueshme që e ndihmon studentin për për realizimin me sukses të programit të studimit, të projektit kërkimor shkencor dhe për përgatitjen e tezës;</p> <p>Kriteri 3 Në bibliotekë ka botime periodike dhe librari elektronike, të cilat përmbajnë libra apo revista shkencore të nevojshme për realizimin me sukses të programit të studimit, të projektit kërkimor shkencor dhe për përgatitjen e tezës;</p> <p>Kriteri 4 Përgjegjësit e programit kanë hartuar një plan të detajuar për shtimin e zërave të bibliotekës në mbështetje të programit të studimit, të projektit kërkimor shkencor dhe për përgatitjen e tezës nga studentët, përfshirë edhe buxhetin e planifikuar për këtë qëllim;</p> <p>Kriteri 5 Biblioteka ka orare të shërbimit në përshtatje me oraret e programeve të studimeve dhe nevojat e studentëve.</p>	<p>Kriteri 1 Institucioni ka siguruar tekste mësimore dhe literaturë ndihmëse bashkëkohore profesionale të mjaftueshme për përmbushjen e kërkesave të programit të studimit që është pjesë e fondit të bibliotekës.</p> <p>Kriteri 2 Në bibliotekë gjendet literaturë e mjaftueshme që ndihmon studentin; Biblioteka elektronike siguron tituj dhe periodikë shkencorë bashkëkohorë që i ndihmojnë studentët për realizimin e programit të studimit sidomos në fazën e përgatitjes së temës së diplomës, duke thekuar këtu që vërtëm një pjesë bën mbrojtjen e temës së diplomës.</p> <p>Kriteri 3 Në bibliotekë gjenden botime periodike dhe librari elektronike e cila është siguruar nga bashkëpunimi me Universitetin të Pireut (http://digilib.lib.unipi.gr/ket/)</p> <p>Kriteri 4 Përgjegjësi i programit “Master Profesional” Teknikë i Lartë në Laboratorët Mjekësorë ka hartuar një plan për rifreskimin e titujve të bibliotekës në përputhje me kërkesat për literaturë të syllabuseve të vecanta.</p> <p>Kriteri 5 Biblioteka funksionon me orar shërbimi në përshtatje me oraret e programeve të studimeve dhe nevojat e studentëve.</p>
<p>Standardi V. 2- Institucioni vë në dispozicion të studentëve laboratorë të mjaftueshëm dhe mjedise të përshtatshme mësimore.</p>	
<p>Kriteri 1 Institucioni dëshmon se ka në sasi të mjaftueshme: laboratorë, klasa, zyra, studio e mjedise të tjera me pajisje elektronike dhe të teknologjisë së informacionit, për realizimin e programit të studimeve;</p> <p>Kriteri 2 Pajisjet e mjediseve mësimore janë të përshtatshme për mësimdhënie në përputhje me qëllimet e programit;</p> <p>Kriteri 3 Laboratorët përmbajnë aparaturat dhe mjetet e nevojshme për plotësimin e kërkesave të</p>	<p>Kriteri 1 Institucioni disponon në sasi të mjaftueshme laboratorë, klasa, zyra, laboratorë informatike, sallë konferencash, salla leksioni dhe seminaresh të paisura me pajisje elektronike për prezantim.</p> <p>Kriteri 2 Mjediset mësimore janë të mobiluara në mënyrë të përshtatshme për një ambient universitar. Paisja e sallave të leksioneve, seminareve dhe laboreve është e përshtatshme për mësimdhënie në përputhje me qëllimet e programit.</p> <p>Kriteri 3 Laboratorët janë të paisur me aparatura dhe mjete të tjera didaktike (tabela prezantuese,</p>

<p>programeve të studimeve dhe për zhvillimin e praktikave të parashikuara nga programi i studimit, në përputhje me qëllimet e programit, si dhe mirëmbahen dhe janë në përmirësim të vazhdueshëm;</p> <p>Kriteri 4 Institucioni, në varësi të programeve të studimeve që ofron, ka së paku një laborator, për secilin grup leksionesh ku parashikohen praktika laboratorike.</p>	<p>skedarë lamash, materiale histopatologjike etj.) të domosdoshme për zhvillimin e programit të studimit.</p> <p>Laboratorët kanë hapësirë të mjaftueshme për të përmbushur nevojat e gjithë studentëve. Pranë ambienteve laboratorike ka personel ndihmës mësimor-shkencor të dedikuar në mirëmbajtje dhe në asistencën e studentëve e pedagogëve gjatë praktikave laboratorike.</p> <p>Nga vizita në IAL konstatohet se laboratorët kanë nevojë për shtim dhe përmirësim të paisjeve dhe për të siguruar punë individuale të pavarur për secilin student. Per momentin, për teknologjitë e reja, mësimi plotësohet nga praktika profesionale që zhvillohet në laboratorë dhe institucione shëndetësore publike ose private me të cilët KU Logos ka lidhur marrëveshje bashkëpunimi.</p>
	<p>Kriteri 4 Institucioni ofron në shërbim të studentëve tre laboratorë mjekësorë (Mikrobiologjik; Biokimik-Klinik dhe Histopatologjik) për çdo grup leksionesh të programit. Numri i laboratorëve është i mjaftueshëm për të realizuar këtë program studimi, por paisjet duhen plotësuar në përputhje me syllabuset e lëndëve përkatëse.</p>

Konkluzionet e vlerësimit:

1. Infrastruktura në dispozicion të programit të studimit paraqitet e përshtatshme dhe e mjaftueshme për realizimin e tij. Ambientet fizike sigurojnë infrastrukturë ndërtimore të mjaftueshme për realizimin e programit Master Profesional dhe Bachelor ne Teknik i Lartë i Laboratorit Mjekësor;
2. Ambientet janë paisur e dedikuar për leksione, seminare, laboratorë informatike e mjekësorë për zhvillimin normal të planit mësimor. Ambientet administrative janë të mjaftueshme për përmbushjen e kërkesave të stafit akademik e ndihmës dhe të studentëve.
3. Biblioteka është e paisur me literaturë universitare në gjuhën shqip e në gjuhë të huaj si dhe disponon librarinë elektronike.
4. Në ambientet kreative në funksion të shërbimit të studentit dhe pedagogëve është dhe palestra e paisur në mënyrë bashkëkohore.
5. ***Rekomandohet që: Laboratorët kanë nevojë për plotësim me pajisje për të siguruar punë praktike individuale të studentëve në nivel më të lartë se programi Bachelor. Institucioni në të ardhmen të shikojë mundësinë e blerjes së pajisjeve të reja për realizimin sa më të mirë të orëve praktike/laboratorike.***

Standardet janë përmbushur plotësisht

5. Financimi dhe menaxhimi i burimeve financiare

Pjesa përshkrimore

Terma reference: burimet e financimit, kostoja për student, kapacitetet menaxhuese.

KU Logos është Institucion jofitimprurës që funksionon financiarisht dhe juridikisht brenda fondacionit Logos; për këtë arsye nuk përgatit pasqyra financiare individuale. Institucioni deklaron si

burime financimi të ardhurat nga kuotat e shkollimit të studentëve, financimin nga Kryepiskopi i KOASH, Prof. Dr. Anastas, president dhe themelues i fondacionit dhe donacionet nga organizata e individë brenda akteve ligjore në fuqi. Në dokumentacionin që shoqëron RVB, Aneksi 14 përmban Pasqyrat Financiare të vitit 2016 për Fondacionin Logos.

Tarifa e shkollimit të ciklit të dytë Master Profesiona në tTeknikë e Lartë në Laboratorë Mjekësorë është e njëjtë me tarifën e shkollimit të ciklit të parë.

Vlerësimi i Treguesve të matshëm:

Të ardhurat dhe financimet e ndryshme në këtë program studimi (në përqindje):

- Grantet për kërkim
- Konsulencat, shërbimet
- Tarifat për dhe gjatë shkollimit
- Sponsorizimet
- Shërbimet trainuese (kualifikimi i vazhdueshëm)
- Donacionet, aktivitetet siguruese, fondacione etj
- Aktivitetet tregtare (mensa, kafe, bare, residencat, etj)

Bazuar në tabelën 8 të RVB janë plotësuar të ardhurat dhe financimet **vetëm** për një vit akademik që nga komenti shoqërues kuptohet se është viti akademik 2016 – 2017.

Shpenzimet për studentët dhe kosto e studimit për student për vit akademik (në përqindje)

Pasqyra financiare e paraqitur ka të dhëna mbi koston për student në vitin akademik 2016 – 2017. Të dhënat nuk janë të mjaftueshme për të shprehur opinionin për raportin në përqindje. Në raport theksohet se kostoja për student është e lartë për shkak të tarifave të shkollimit të ulëta dhe numrit të pakët të studentëve të regjistruar.

Dokumentacioni përkatës i marrë në vizitat në institucion

Gjatë vizitës në institucion u informuam për vendimin e Bordit të Administrimit për të akorduar në buxhetin e vitit 2018 një fond për mbështetjen e aktivitetit shkencor të stafit akademik, si dhe për vendimet e Senatit Akademik dhe Rektoratit për akordimin e Bursave të Studimit për studentë të ekselencës dhe Bursave sociale. Dokumentacioni përkatës na u vu në dispozicion.

Vlerësimi sipas Standardeve

Standardi/Kriteret	Vlerësimi sipas standardeve
Standardi II.9 - Institucioni bën një auditim të përvitshëm (të jashtëm dhe/ose të brendshëm) të situatës financiare.	
Kriteri 1 Raporti i auditit paraqet të gjithë situatën financiare për përdorimin e buxhetit të vënë në dispozicion për realizimin e programeve të studimeve të ciklit të dytë dhe programeve të integruara të studimeve të ciklit të dytë;	Kriteri 1 Institucioni është Fondacion jo fitimprurës. Nuk është paraqitur raport i auditit për situatën financiare. Kriteri i paaplikueshëm
Kriteri 2 Raporti i auditit përmban një pasqyrë të qartë të granteve të huaja të përfituara dhe kontratave të shërbimeve të lidhura në funksion të realizimit të programeve të studimeve të ciklit të dytë dhe programeve të integruara të studimeve të ciklit të	Kriteri 2 Institucioni është Fondacion jo fitimprurës. Nuk është paraqitur raport i auditit për situatën financiare. Kriteri i paaplikueshëm
	Kriteri 3 Institucioni është Fondacion jo

<p>dytë;</p> <p>Kriteri 3 Raporti i auditit analizon eficiencën e përdorimit të të ardhurave nga tarifat e studentëve në funksion të rritjes së cilësisë së studimeve në këtë cikël studimesh.</p>	<p>fitimprurës. Nuk është paraqitur raport i auditit për situatën financiare. Kriteri i paaplikueshëm</p>
<p>Standardi VI.1 - Institucioni harton një raport financiar të kostove të programeve të studimeve.</p>	
<p>Kriteri 1 Institucioni harton një raport që pasqyron të dhëna të hollësishme financiare të kostove për realizimin e programeve të studimeve, si kostot operacionale, kostot fikse të mjediseve dhe të pajisjeve, etj.</p> <p>Kriteri 2 Institucioni dëshmon se ka një qëndrueshmëri financiare përgjatë kohës së zhvillimit të programeve të studimeve dhe se ka kapacitete financiare të mjaftueshme për përmirësimin e situatës financiare dhe gjenerimin e të ardhurave në të ardhmen.</p>	<p>Kriteri 1 Institucioni ka hartuar raport financiar ku pasqyrohen në trajtë globale investimet, të ardhurat, shpenzimet etj. (tabela 8 e RVB). Raporti nuk është i plotë.</p> <p>Kriteri 2 Institucioni e mbështet qëndrueshmërinë financiare në të ardhurat nga kuotat e studentëve dhe në të ardhurat nga themeluesi i fondacionit Prof. Dr. Anastasi që garanton qëndrueshmërinë financiare përgjatë kohës së zhvillimit të programit të studimit</p>
<p>Konkluzionet e vlerësimit:</p> <ol style="list-style-type: none"> 1. KU Logos është institucion financiar jofitimprurës që funksionon brenda Fondacionit Logos që garanton financiarisht institucionin. 2. Të ardhura të tjera deklarohen të ardhurat nga kuotat e shkollimit të studentëve dhe donacionet. 3. Tipari jofitimprurës theksohet si kriter i KU Logos dhe pasqyrohet dhe në tarifat e studimit për të gjitha programet e ciklit të parë dhe të dytë <p>Standardet janë përmbushur plotësisht</p>	

6. Sistemi i Brendshëm i Sigurimit të Cilësisë

Pjesa përshkrimore

Terma reference: institucionalizimi i sistemit të brendshëm të sigurimit të cilësisë, ngritja e Njësisë së SBC, funksionimi i saj, vetëvlerësimi dhe përmirësimi i vazhdueshëm i cilësisë, rezultatet e vlerësimeve të jashtme.

Në përmbushje të standarteve aktuale të cilësisë në arsimin e lartë, institucionalizimi i sigurimit të brendshëm të cilësisë është detyrim ligjor për të gjithë institucionet e arsimit të lartë. Në këtë kuadër SHLP Logos ka ngritur me vendim senati që në vitin 2011 Njësinë e Brendshme të Sigurimit të Cilësisë (NJBSC) riorganizuar pas reformës në vitin 2014. Pas hyrjes në fuqi të Ligjit të Arsimit të Lartë Nr. 80/ 2015, KU Logos ka riorganizuar NJBSC me vendim senati Nr.7 dt. 08.02.2018. NJBSC funksionon në nivel institucional dhe në nivel fakultetesh. Grupi i vlerësimit të jashtëm kontaktoi me NJBSC.

Vlerësimi i Treguesve të matshëm:

Të dhëna sasiore për punën konkrete në NJSBC për programin e studimit, si:

- Sa anketime kanë bërë me studentët
- Sa studentë janë anketuar
- Sa prej tyre janë përpunuar dhe çfarë problemesh kanë dalë
- Cilat kanë qenë hapat e mëtejshëm
- Etj

NJSBC që nga riorganizimi ka bërë 1 anketi me studentët. Janë anketuar 14 studentë. Janë përpunuar të dhënat e formularëve prej të cilave po rendisim disa prej rezultateve:

- Transparenca në vlerësimin e provimeve – 72%
- Disponibiliteti i pedagogëve – 93%
- Vlerësimi i punës së stafit akademik: 14% mirë, 29% shumë mirë, 57% shkëlqyeshëm
- Vlerësimi pozitiv për aktivitetin praktik – 80%
- Vlerësimi i infrastrukturës – ndotje akustike, nevojë për hapësirë rekreative.

Hap i mëtejshëm pas nxjerrjes së rezultateve ka qenë prodhimi i raporteve përmbledhëse që i janë vënë në dispozicion stafit, studentëve dhe publikohen në faqen eeb të institucionit.

NJBSC e riorganizuar në këtë vit akademik ka punuar për rishikimin e rregulloreve për të eliminuar mbivendosjet e kompetencave. Pas analizës së pyetësorit standart të ASCAL të cilët ishin zhvilluar në kuadër të akreditimit Institucional, NJBSC referon se ka bërë një rivlerësim të formularit të përdorur në të shkuarën për anketimin e studentëve. NJBSC ka aplikuar sistemin e anketimit semestral (në fund të semestrit, para provimit) të studentëve për vlerësimin e mësimdhënies, kurrikulës, organizimit të procesit mësimor etj. Në anketime janë përfshirë grupe studentësh me rreth 14 pjesmarrës për ciklin Master Profesional dhe Bachelor. NJBSC ka përpunuar të dhënat e përfuara nga anketimet dhe kontrollat duke prodhuar dokumenta për përmirësimin e punës që konsistojnë në tabela krahasuese të vlerësimit për pedagogët, për paisjet, ambientet, performancën e programit etj. Në dokumentacionin shoqëruar disponojmë pyetsorit tip të përdorur në vitin 2016 – 2017 si dhe analizën e pyetsorit mbi vlerësimin e pedagogëve. Grupi i vlerësimit u njoh me procesin e plotë në takimin me NJBSC.

Kontrolli i brendshëm i cilësisë

Kontrolli i brendshëm i cilësisë udhëhiqet nga NJBSC dhe përdor metodologji vlerësimi, instrumente matëse dhe vlerësuese për ecurinë e programit të studimit. (metodologjia e vlerësimit, dokument bashkangjitur aplikimit)

Përgjegjësitë në monitorimin dhe menaxhimin e cilësisë deri në nivel departamenti

Grupi i vlerësimit të brendshëm të cilësisë ngrihet nga senati dhe udhëheq procesin e vlerësimit. Rezultatet e përfuara nga ky proces referohen në rrugë vertikale dhe horizontale (senat, departamente dhe fakultete)

Vetëvlerësimet e kryera dhe rezultatet e tyre

Është paraqitur metodologjia e vlerësimit të brendshëm dhe modeli i pyetsorit me disa rezultate.

Politikat e përmirësimit të cilësisë mbi bazën e vetëvlerësimeve periodike

Institucioni është i angazhuar në publikimin e vlerësimeve periodike në formën e raporteve vjetore. Institucioni monitoron në mënyrë periodike programet mësimore dhe procesin e mësimdhënies në funksion të sigurimit të cilësisë. Nisur nga problematikat e evidentuara gjatë anketimeve në raport me programin mësimor apo me eksperiencën praktike, institucioni ka vendosur organizimin e takimeve me punëdhënës e studentë për shkëmbimin e ideve në funksion të përmirësimit të programit dhe cilësisë së mësimdhënies.

Gjatë takimeve në institucion GVJ konstatoi se të dhënat e vetëvlerësimit përputhen me gjëndjen e konstatuar si dhe u njoh në detaje me mënyrën e funksionimit të NJSBC dhe strategjinë e saj.

Vlerësimi sipas Standardeve

Standardi/Kriteret	Vlerësimi sipas standardeve
Standardi I.10 - Institucioni përdor metodologji vlerësimi, instrumente matëse dhe vlerësuese për ecurinë e programeve të studimeve.	
<p>Kriteri 1 Institucioni përdor metodologji vlerësimi, instrumente matëse dhe vlerësuese për ecurinë e programeve të studimeve;</p> <p>Kriteri 2 Institucioni e përfshin këtë informacion në vetëvlerësimin që bën për arritjen e sigurimit të brendshëm të cilësisë;</p> <p>Kriteri 3 Institucioni publikon rezultatet e vlerësimit dhe rezultatet që synon të arrijë;</p> <p>Kriteri 4 Institucioni, për kryerjen e vlerësimit, përdor metoda të tërthorta ose të drejtpërdrejta.</p> <p><u>Të tërthorta:</u></p> <ol style="list-style-type: none">Sondazhe: të studentëve që ndjekin programet e studimeve, të të diplomuarve në këto programe në vitet e mëparshme akademike apo në ciklet e ndryshme të studimeve;Sondazhe të vlerësimit të mësimdhënies, kurrikulës, të të mësuarit;Pyetje konceptuale;Intervista;Etj. <p><u>Të drejtpërdrejta:</u></p> <ol style="list-style-type: none">Rezultatet e arritura nga studentët në teste të standardizuara kombëtare/ndërkombëtare (p.sh. provimi i shtetit për profesionet e rregulluara, etj);Dëgjime në auditor;Rezultatet e arritura nga studentët në provimet e vlerësuara me nota/pikë;	<p>Kriteri 1 NJBSC e ngritur nga institucioni përdor metodologji vlerësimi, instrumenta matëse dhe vlerësuese për ecurinë e programit.</p> <p>Kriteri 2 Institucioni e përdor këtë informacion në vetëvlerësimin që bën për arritjen e sigurimit të brendshëm të cilësisë; informacioni përfshihet dhe në raportin e punës vjetore të institucionit.</p> <p>Kriteri 3 Njësia është riorganizuar këtë vit akademik dhe rezultatet përfundimtare nuk kanë ende formë të plotë. Publikimi i rezultateve të vitit të kaluar është realizuar në formë raporti dhe i është komunikuar stafit dhe studentëve. Raportet publikohen dhe në faqen ëeb të KU Logos.</p> <p>Kriteri 4 Institucioni, për kryerjen e vlerësimit, përdor metoda të tërthorta ose të drejtpërdrejta. Ndër metodat e tërthorta përmendim shpërndarjen e sondazheve e pyetësorëve tek studentët dhe analiza e tyre. Në të njëjtën kohë Institucioni përdor dhe metoda të drejtpërdrejta të vlerësimit si:</p> <ul style="list-style-type: none">– Analiza e rezultateve të provimit të shtetit për profesionet e rregulluara (Teknikë i Lartë Laboratorësh Mjekësorë); studentët që morën pjesë në provimin e shtetit dolën të gjithë <i>fitues</i> gjë që dëshmon edhe seriozitetin e punës së shkollës– Dëgjimi në auditor– Analiza e vlerësimeve në auditor me notë ose pikë për testimet paraprake, modulet, praktikat, provimet përfundimtare etj.– Praktikrat profesionale të kryera nga studenti

<p>d. Rezultatet e arritura nga studentët në testimet paraprake dhe përfundimtare, provimet për module, praktikat profesionale;</p> <p>e. Rezultatet e arritura nga studentët në vlerësimin e detyrave të kryera gjatë zhvillimit të programit të studimit (punë individuale apo në grup, detyra kursi për të analizuar të kuptuarit konceptual, referatat, projektet, provimet, etj.);</p> <p>f. Vëzhgime gjatë kryerjes së ushtrimeve/praktikës;</p> <p>g. Rezultatet e arritura dhe cilësia e rezultatit të kërkimit - tezës;</p> <p>h. Etj.</p>	<p>mbikëqyren dhe vlerësohen nga pedagogu i caktuar nga departamenti si dhe nga drejtuesi i njësisë ku kryhet praktika (Qendra mjekësore).</p> <p>Për çdo semestër departamenti i programit të ciklit të dytë "Master Profesional" bën analizën e punës mësimore shkencore dhe në fund të vitit harton një raport të analizës vjetore.</p>
<p>Standardi I.13 - Institucioni publikon rregullisht informacion të paanshëm dhe objektiv, sasior e cilësor, për vlerësimin e brendshëm.</p>	
<p>Kriteri 1 Institucioni publikon rregullisht broshura, buletine etj., të hartuara dhe botuara nga institucioni, për vlerësimin e brendshëm;</p> <p>Kriteri 2 Institucioni publikon rregullisht prezantime në faqe interneti, video e audio etj. për vlerësimin e brendshëm.</p>	<p>Kriteri 1 Institucioni shpreh vullnet për publikimin e broshurave për rezultatet e vlerësimit të brendshëm të cilësisë.</p> <p>Kriteri 2 Institucioni ka një faqe publikimi ëb në të cilën publikon informacione për infrastrukturën institucionale, programet e studimit, kriteret e pranimit të studentëve, kualifikimin e stafit akademik etj. Po punohet për krijimin e hapësirës dedikuar publikimeve për vlerësimin e brendshëm të cilësisë.</p>
<p>Standardi II.7 - Institucioni kryen një analizë vjetore për vlerësimin e programeve të studimeve të ciklit të dytë dhe programet e integruara të studimeve të ciklit të dytë.</p>	
<p>Kriteri 1 Institucioni harton një analizë vjetore për vlerësimin e ecursisë së programeve të studimeve të ciklit të dytë dhe programeve të integruara të studimeve të ciklit të dytë;</p> <p>Kriteri 2 Institucioni harton politika që synojnë përmirësimin e programeve të studimeve të ciklit të dytë dhe programeve të integruara të studimeve të ciklit të dytë.</p>	<p>Kriteri 1 Institucioni bën analizë të detajuar vjetore të ecursisë së programit të studimit të ciklit të dytë Master Profesional në Teknikë e Lartë në Laboratorë Mjekësorë.</p> <p>Kriteri 2 Politikat e institucionit parashikojnë dhe synojnë përmirësimin e programit të studimit, rishikimin e përmirësimin e Syllabuseve si dhe aplikimin e metodave interaktive në mësimdhënie.</p>
<p>Standardi VIII.1 - Institucioni garanton sigurimin e cilësisë në realizimin e programeve të studimeve.</p>	
<p>Kriteri 1 Institucioni ka plotësuar standardet institucionale dhe është akredituar në nivel institucional përpara aplikimit për akreditimin e programeve të studimeve;</p> <p>Kriteri 2 Institucioni përdor instrumentet e duhura për sigurimin e cilësisë;</p> <p>Kriteri 3 Institucioni harton një politikë dhe ndjek procedura të caktuara për sigurimin e cilësisë dhe standardeve të programeve të tyre;</p>	<p>Kriteri 1 KU Logos është akredituar në nivel institucional dhe për programet e studimit të ciklit të parë "Bachelor".</p> <p>Kriteri 2 Sigurimi i cilësisë është një ndër prioritetet e institucionit. Për të realizuar këtë objektiv institucioni përdor instrumentet e sugjeruar nga legjislacioni në fuqi dhe mbështetet në praktikat kombëtare për sigurimin e cilësisë.</p> <p>Kriteri 3 Në statutin dhe rregulloren e institucionit si dhe në rregulloren e programit</p>

<p>Kriteri 4 Institucioni përdor mekanizma formalë për shqyrtimin, miratimin dhe mbikëqyrjen e herëpashershme të programeve të studimit;</p> <p>Kriteri 5 Institucioni synon ndërgjegjësimin e personelit të vet dhe të studentëve që ndjekin programet e studimeve që ofrohen, për rëndësinë e cilësisë dhe sigurimin e cilësisë në to;</p> <p>Kriteri 6 Institucioni harton dhe zbaton një strategji për përmirësimin e vazhdueshëm të cilësisë. Strategjia, politika dhe procedurat janë publikuar.</p>	<p>“Master Profesional” në Teknikë e Lartë në Laboratorë Mjekësorë janë parashikuar procedurat e menazhimit të cilësisë.</p> <p>Kriteri 4 NJBSC e ngitur me vendim senati është organi përgjegjës për vlerësimin dhe mbikëqyrjen e programit të studimit.</p> <p>Kriteri 5 Institucioni inkurajon takimet e herëpashershme formale dhe joformale të personelit me studentët me qëllim tërheqjen e opinionëve dhe informimin e studentëve në funksion të sigurimit të cilësisë. Në rol të vecantë në këtë fushë ka dhe Njësia e Këshillimit të Karrierës.</p> <p>Kriteri 6 Strategjia për përmirësimin e vazhdueshëm të cilësisë është pjesë e strategjisë të zhvillimit të institucionit dhe publikohet në broshurat dhe faqen e internetit të tij.</p>
<p><u>Konkluzionet e vlerësimit:</u></p> <ol style="list-style-type: none"> 1. Njësia e Sigurimit të Brendshëm Të Cilësisë e riorganizuar në shkurt të vitit 2018 funksionon për të përmbushur detyrimet e saj. 2. Institucioni përdor metodologji vlerësimi dhe instrumenta matëse për ecurinë e programit të studimit. 3. Strategjia, politika dhe procedurat që ndiqen për përmirësimin e vazhdueshëm të cilësisë janë të publikuara në broshura dhe faqen e internetit. Ato iu prezantohen studentëve dhe në takime formale e joformale me personelin. <p>Standardet janë përmbushur plotësisht</p>	

POLITIKAT E FORMIMIT TË STUDENTËVE

7. Programi i studimit, organizimi i tij


Pjesa përshkrimore

Terma reference: misioni dhe objektivi i programit të studimit, përmbajtja e programit, organizimi i vitit mësimor, semestrat, plani mësimor me të gjithë elementët e tij (lëndët/modulet, kreditet përkatëse, ndarja e orëve për çdo kredit në varësi të formave të studimit, orët mësimore përkatësisht në auditor/jashtë auditorit të ndara sipas formave të mësimdhënies), literatura dhe materiale të tjera mbështetëse e ndihmëse, etj

Kolegji Universitar Logos, ka paraqitur në mënyrë të zgjeruar dhe të argumentuar misionin, objektivat e programit të studimit, përmbajtjen e programit të studimit, mënyrën e organizimit, planet mësimore, syllabuset dhe literaturën e rekomanduar etj.

Vlerësimi i Treguesve të matshëm:

Viti i fillimit, qëllimet dhe objektivat e çdo programi studimi

MPC 

Programi i studimit Master Profesional në Teknik i Lartë Laboratorësh Mjekësorë ka filluar funksionimin e tij në vitin akademik 2013 – 2014.

Misioni i programit të studimit të ciklit të dytë “Master Profesional” në Teknik i Lartë Laboratorësh Mjekësorë është t’u japë studentëve që zotërojnë diplomë universitare Bachelor njohuri të thelluara teorike dhe praktike si dhe një trajnim të mirëfilltë profesional.

Objektivat e programit të studimit “Master Profesional” në Teknik i Lartë Laboratorësh Mjekësorë janë:

- Rritja në cilësi e njohurive profesionale dhe shkencore të përfituara nga studimet Bachelor
- Përgatitja e specialistëve të profilizuar për laboratorët mjekësorë dhe të aftë të njohin e të përdorin teknologjinë e aparaturave bashkëkohore të laboratorëve mikrobiologjikë, biokimiko-klinikë dhe të histologjisë
- Krijimi i figurës së ekspertit në fushën e laboratorëve, i aftë për të kryer analiza me cilësi të lartë dhe të përdorë teknologjinë bashkëkohore për të kryer analizat
- Hapja e perspektivës për të diplomuarit në “Master Profesional” në Teknik i Lartë Laboratorësh Mjekësorë, që me disa plotësime të kenë mundësi të regjistrohen në ciklin e tretë të studimeve, doktoraturë.

Organizimi i programit të studimit (vite, semestra, javë etj.)

Programi i studimit ka qënë i organizuar në 1.5 vite akademike, 3 semestra me 45 javë mësimore në auditor dhe me 90 ECTS në total. Prej vitit akademik 2017-2018 ofrohet në 1 vit akademik dhe me 60 ECTS. Me riorganizimin e strukturës, programi që është paraqitur për akreditim është i organizuar:

- Në 1 vit akademik: 30 javë mësimore në auditor
- Në 2 semestra: cdo semestër ka 15 javë mësimore në auditor
- Numri total i krediteve të programit është 60 ECTS
- 1 orë mësimore – 60 minuta
- 1 ECTS = 25 orë mësimore punë të studentit

Plani mësimor sipas viteve akademike, ndarja e ECTS sipas formave të mësimdhënies për çdo lëndë (Plotësoni Tabelën ne Aneks)

Në planet mësimore dhe syllabuset është paraqitur numri total i ECTS-ve për cdo lëndë dhe ndarja e orëve mësimore sipas tipit të mësimdhënies. **Nuk jepet ndarja e ECTS-ve sipas formave të mësimdhënies. Tabela 10 e RVB nuk është plotësuar sipas standartit.** Nga të dhënat e tabelës dhe të planeve mësimore konstatohet se lëndë me të njëjtin numër orësh në auditor, kanë numër të ndryshëm ECTS.

Në planin mësimor 50% e ECTS-ve i përkasin disiplinave të formimit karakterizues (B), rreth 13% e ECTS-ve i përkasin disiplinave të formimit të përgjithshëm (A), rreth 18% e ECTS-ve i përkasin disiplinave të ngjashme ose integruese (C) dhe disiplinave me zgjedhje (D), rreth 18% e ECTS-ve shkojnë për praktikën profesionale dhe detyrimet e diplomimit (provim dhe/ose temë diplome). Në përgjithësi shpërndarja e ECTS-ve sipas disiplinave të ndryshme është korrekte për programin mësimor. Sugjerojmë, shtimin në të ardhmen të ECTS-ve për disiplinat integruese.

Mënyra e përcaktimit të krediteve (ECTS) për format e studimit:

- Për leksionet 10 orë në auditor /15 orë punë e pavarur e studentit
- Për Seminaret 10 orë në auditor /15 orë punë e pavarur e studentit
- Për Labororet 10 orë në auditor /15 orë punë e pavarur e studentit
- Për Praktikën Profesionale 60 orë punë e pavarur e studentit
- Provimi përfundimtar/Përgatitja e temës së Diplomës 15 orë në auditor dhe 35 orë punë e pavarur e studentit

Në mënyrën e përcaktimit të krediteve konstatohet se është përdorur e njëjta skemë për leksionet, seminaret dhe labororet. Nuk është marrë parasysh fakti që studenti bën më shumë

punë të pavarur për leksion dhe më pak për laborator. Në evidentimin e orëve të praktikës profesionale, orët janë konsideruar punë e pavarur, por në fakt janë punë e mbikqyrur; vëndi i praktikës është auditor. Ka mospërputhje të deklarimeve të shpërndarjes së orëve për ECTS për provimin përfundimtar/diplomën dhe praktikën profesionale midis RVB dhe tabelës 12 të plotësuar dhe vënë në dispozicion të GVJ pas vizitës në institucion. ***I rekomandojmë institucionit të rishikoj edhe një hërë sylabuset duke u bazuar në udhëzimet në fuqi.***

- Ndryshimet në Planet mësimore, krahasuar me programet mësimore të licensuara (Plotësoni Tabelën ne Aneks)

Plani mësimor i ciklit të dytë Master Profesional në Teknikë e Lartë në Laboratorë Mjekësorë që është paraqitur për akreditim ka ndryshime krahasuar me planin mësimor të licensuar (90 ECTS). Kjo nuk është pasqyruar në RVB ku tabela 12 nuk është plotësuar. Pas vizitës në institucion, na u vu në dispozicion tabela 12 e plotësuar në të cilën konstatohen ndryshimet e mëposhtme të cilat duken të justifikuara:

- Janë hequr nga programi dy lëndë të cilat paraqesnin karakter më të avancuar shkencor dhe përbënin subjekt për një stad të mëtejshëm të studimeve. Lënda Metodologji e kërkimit shkencor (C) dhe Lënda Epidemiologji (B)
- Për lëndë të tjera u bënë ndryshime në numer kreditesh për orë mësimore bazuar në hapësirën që lejohet në raportin orë mësimore /kredit.
 1. Praktika profesionale u ndryshua nga 10 kredite në 6 kredite për shkak të uljes së orëve të praktikës nga 250 orë në 60 orë
 2. Lënda kimi analitike nga 6 kredite u bë 4 kredite duke e ndarë lëndën sipas udhëzimit mbi raportin e leksioneve, seminareve dhe praktikave (2 leksione/1seminar/1 praktikë)
 3. Lënda sëmundje infektive nga 6 kredite u bë 4 kredite. Lënda nuk ka praktika mësimore.

- Planet mësimore të lidhura me personelin akademik përkatës (Plotësoni Tabelën ne Aneks)

Personeli akademik që mbulon programin “Master Profesional” përbëhet përgjithësisht nga personalitete me eksperiencë dhe kualifikim të lartë profesional në fushat përkatëse. Në dy raste fusha e ekspertizës së pedagogut nuk përputhet me sylabusin e lëndës në të cilën është titullar duke ndikuar direkt në cilësinë e mësimdhënies.

- Vlerësimi për Syllabus-et dhe elementët e tyre, për çdo lëndë.

➤ Emërtimi i lëndës/modulit

Janë deklaruar të dhënat lidhur me emërtimet e cdo lënde dhe moduli; sugjerojmë ndryshimin e emërtimit për lëndën “Kimi Analitike” në “Metodat e analizave biokimike”

➤ Viti/semestri kur zhvillohet lënda

Eshtë deklaruar qartë viti/semestri ku zhvillohet lënda

➤ Emri i pedagogut që do të zhvillojë lëndën

Eshtë deklaruar (shih tabelën) emri i pedagogut që do të zhvillojë lëndën. Në dy raste, fusha e ekspertizës së pedagogut nuk përputhet me programin e lëndës. Biokimia Klinike, lëndë mjekësore – jepet nga specialist kimist pa asnjë kualifikim apo eksperiencë praktike në aplikimin dhe interpretimin e testeve laboratorike në funksion të diagnozës mjekësore. Titullari i lëndës “Analiza Klinike e Gjakut dhe Lëngjeve Biologjike” (mikroskopi qelizore), është fizikant.

Vendi që zë lënda në formimin tërësor të studentit

Eshtë deklaruar qartë në sylabus vendi që zë lënda në formimin tërësor të studentit.

➤ Njohuritë paraprake që duhet të ketë studenti për përvetsimin e lëndës

Për secilën lëndë janë dhënë qartë kushtet për njohuritë paraprake.

➤ Çfarë njohurish dhe aftësish i jep studentit kjo lëndë

Cdo program lënde është shoqëruar me një përmbledhje të aftësive, njohurive dhe kompetencave që lënda i jep studentit.

➤ Temat që do të trajtojnë lënda në formimin teorik dhe praktik

Tematikat janë përshkruar në mënyrë të detajuar sipas formave të masimdhënies dhe orëve përkatëse për secilën temë.

➤ Ngarkesa në orë në auditor dhe jashtë auditorit si dhe në ECTS

Në planin mësimor (tabela 10 e RVB) është dhënë numri i orëve në auditor dhe jashtë auditorit për secilën lëndë të programit studimor. Në cdo syllabus shpërndarja e orëve sipas formave të masimdhënies është paraqitur në formë tabelare.

➤ Format dhe metodat e masimdhënies të lëndës dhe raportet midis tyre

Janë deklaruar format dhe metodat e masimdhënies dhe raportet mes tyre.

➤ Format e vlerësimit të studentëve

Është paraqitur mënyra e vlerësimit të studentëve shoqëruar dhe me sqarimet përkatëse. Megjithëse në rregulloren e programit të studimit mënyra e vlerësimit të studentëve është e unifikuar, në ndonjë prej syllabuseve ka shmangie nga rregulli.

➤ Detyrimet e studentit për lëndën

Në rregullore, në planin mësimor dhe në syllabuse janë përcaktuar detyrimet e studentit për lëndën

➤ Literatura e detyruar dhe ajo ndihmëse

Për cdo lëndë është deklaruar literatura. Baza në disa prej lëndëve janë leksionet e pedagogëve shoqëruar me literaturë të huaj.

Analizë e cilësisë së syllabuseve

Tematikat e syllabuseve janë në përgjithësi bashkëkohore dhe në koherencë me programin e studimit. Syllabuset janë aprovuar nga Dekani dhe Përgjegjësi i Departamentit. Sugjeruam përmirësimin e syllabuseve dhe formatimin e tyre sipas një modeli.

Dokumentacioni përkatës i marrë në vizitat në institucion

Në institucion u konsultuan dhe një herë syllabuset e lëndëve dhe u panë dokumentacionet e vlerësimit të studentëve, regjistrat e lëndëve, u asistua në orë mësimore praktike për të kuptuar mënyrën e aplikimit të temave në laborator etj. Disa prej syllabuseve, të riformatuar na u vunë në dispozicion në rrugë elektronike pas vizitës në institucion.

Vlerësimi sipas Standardeve

Standardi/Kriteret	Vlerësimi sipas standardeve
Standardi I.1 - Institucioni ofron programe studimesh në përputhje me misionin dhe qëllimin e tij.	
Kriteri 1 Institucioni ofron programe të akredituara të studimeve, të organizuara në module dhe të vlerësuara në kredite, sipas Sistemit Europian të Transferimit dhe Grumbullimit të Krediteve (ECTS);	Kriteri 1 KU Logos, ofron programe studimi të ciklit të parë “Bachelor” të akredituara dhe të organizuara në module dhe të vlerësuara në kredite sipas Sistemit Europian të Transferimit dhe Grumbullimit të Krediteve (ECTS). Institucioni ka paraqitur për akreditim programin e studimit Master Profesional të organizuar në module dhe të vlerësuara në kredite sipas Sistemit Europian të Transferimit dhe Grumbullimit të Krediteve (ECTS).
Kriteri 2 Sasia mesatare e krediteve të grumbulluara gjatë një viti nga një student që ndjek një program studimi me kohë të plotë është 60 kredite;	Kriteri 2 Sasia mesatare e krediteve të grumbulluara gjatë një viti nga një student që ndjek një program

	studimi Master Profesional me kohë të plotë është 60 kredite.
Standardi I.2 - Programet e studimeve janë në përputhje me strategjinë për zhvillim të institucionit.	
<p>Kriteri 2 Programet e studimeve të ciklit të dytë “Master i Shkencave”, “Master i arteve të bukura” apo “Master Profesional” i pajisin studentët që zotërojnë diplomën universitare “Bachelor” me njohuri të thelluara, teorike dhe praktike, si dhe trajnim për kërkim shkencor apo trajnim të mirëfilltë profesional;</p> <p>Kriteri 3 Programet e studimeve “Master i Shkencave” ose “Master i arteve të bukura” dhe “Master Profesional” synojnë të zgjerojnë njohuritë e fituara në ciklin e parë të studimeve;</p>	<p>Kriteri 2 Programi i studimeve të ciklit të dytë “Master Profesional” i pajis studentët që zotërojnë diplomën Bachelor me njohuri të thelluara teoriko-praktike, trajnim të mirëfilltë profesional si dhe me trajnim për kërkim shkencor.</p> <p>Kriteri 3 Programi i studimeve të ciklit të dytë “Master Profesional” synon të zgjerojë njohuritë e fituara në ciklin e parë të studimeve “Bachelor”.</p> <p>Kriteri 4 Pas përfundimit me sukses të provimit të shtetit, studentët fitojnë të drejtën e ushtrimit të profesionit të rregulluar “Laborant i Lartë Mjekësor” sipas ligjit në fuqi. Ata mund të ushtrojnë këtë profesion në laboratorët mjekësorë spitalorë, ambulatorë, publikë ose privatë.</p> <p>Kriteri 5 Programi i studimit “Master Profesional” i pajis studentët me kompetenca të përgjithshme profesionale të cilat synojnë të zgjerohen gjatë zhvillimit të tij. Ky kriter përmbushet nga kombinimi i lëndëve teorike me praktikën profesionale.</p> <p>Kriteri 6 Kriter i paaplikueshëm për këtë program studimi.</p> <p>Kriteri 7 Programi i studimit “Master Profesional” ka objektiva të qartë profesionale, të justifikueshëm, të arritshëm, me synime të qarta për arritjen e kualifikimit të nevojshëm dhe në përputhje me kërkesat e tregut të punës.</p>
<p>Kriteri 4 Programet e integruara të studimeve të ciklit të dytë (në mjekësi, stomatologji, farmaci, veterinari, arkitekturë) i pajisin studentët me njohuri të thelluara dhe kompetenca shkencore, teorike dhe praktike, si dhe trajnim për kërkim shkencor sipas fushës. Pas përfundimit të tyre si dhe përfundimit me sukses të provimit të shtetit për programin specifik, studentët fitojnë të drejtën e ushtrimit të një profesioni të rregulluar sipas ligjit në fuqi;</p> <p>Kriteri 5 Programet e studimeve të këtij cikli i pajisin studentët me kompetenca të përgjithshme dhe profesionale që synohen të arrihen apo të zgjerohen gjatë zhvillimit të tij;</p> <p>Kriteri 6 Programet e studimeve “Master i Shkencave” ose “Master i arteve të bukura” dhe programet e integruara të studimeve të ciklit të dytë krijojnë baza të qëndrueshme njohurish për studimet e ciklit të tretë doktoratës, duke përfshirë aftësimin për kërkimin shkencor dhe plotësimin e parakushteve (njohuri, aftësi dhe kompetenca) për pranimin në ciklin e tretë të studimeve;</p> <p>Kriteri 7 Programet e studimeve “Master Profesional” kanë objektiva të qartë profesionale, të justifikueshëm, të arritshëm, me synime të qarta për arritjen e kualifikimit të nevojshëm dhe në përputhje me kërkesat e tregut të punës.</p>	
Standardi I.4 - Programet e studimeve ofrohen në përshatje me nivelin e studimeve.	
Kriteri 1 Përmbajtja dhe renditja e objektivave të programeve të studimeve synojnë arritjen e qëllimeve të tyre në përputhje me nivelin e	Kriteri 1 Objektivat e deklaruara në këtë program studimi janë në përputhje me nivelin e studimeve në të cilat ofrohen

<p>studimeve në të cilin ofrohen ato;</p> <p>Kriteri 2 Metodat e vlerësimit të studentëve nëpërmjet kontrollit të vazhdueshëm të njohurive me anë të testeve me përgjigje alternative apo provimeve përfundimtare dëshmojnë ecurinë dhe arritjet e studentëve për ciklin përkatës të studimeve.</p>	<p>Kriteri 2 Në vlerësimin e studentëve përfshihet vlerësimi për pjesmarrje aktive në auditor, për punë laboratorike, vlerësimi me teste të ndërmjetme, vlerësimi për praktikën profesionale, vlerësimi përmes provimit përfundimtar. Vlerësimi i gjithanshëm siguron dëshmi të besueshme për ecurinë dhe arritjet e studentëve për ciklin e studimeve “Master Profesional” në Teknikë e Lartë në Laboratorë Mjekësorë.</p>
<p>Standardi I.5 - Programet e studimeve synojnë të arrijnë dimensione ndërkombëtare.</p>	
<p>Kriteri 1 Programet e studimeve mbështeten në përvojën disavjeçare dhe praktikën e mira të vendeve europiane;</p> <p>Kriteri 2 Programet e studimeve janë ndërkombëtarisht konkurruese për nga elementet që përmbajnë (të dhëna të përgjithshme, objektivat kryesorë, plani mësimor, kreditet, kushtet e pranimit në tometodat e vlerësimit, kriteret dhe procedurat e transferimit të krediteve e njohurive të fituara, diplomat që jepen në përfundim etj.) duke afirmuar vlerat e arsimit universitar në Shqipëri;</p> <p>Kriteri 3 Programet e studimeve janë hartuar në përputhje me objektivat e përcaktuar në legjislacionin dhe direktivat e BE-së për arsimin e lartë dhe profesionet e rregulluara.</p>	<p>Kriteri 1 Programi i studimit është mbështetur në përvojën disavjeçare të KU Logos në këtë fushë studimi si dhe në eksperiencat europiane.</p> <p>Kriteri 2 Programi i studimit “Master Profesional” në Teknikë e Lartë në Laboratorë Mjekësorë është ndërtuar mbështetur në direktivat e BE dhe kriteret e sistemit të Bolonjës. Ai mund të jetë objekt i transferimit dhe konvalidimit të krediteve.</p> <p>Kriteri 3 Programi i studimit është hartuar në përputhje me legjislacionin kombëtar për arsimin e lartë dhe profesionet e rregulluara.</p>
<p>Standardi I.6 - Programet e studimeve përfshijnë aftësimin profesional dhe kërkimin shkencor.</p>	
<p>Kriteri 1 Programet e studimeve të ciklit të dytë dhe programet e integruara të studimeve të ciklit të dytë përfshijnë aftësimin profesional dhe kërkimin shkencor;</p> <p>Kriteri 2 Programet e studimeve hartohen në përputhje me profilin e Institucionit të Arsimit të Lartë dhe strategjinë e tij për zhvillim;</p> <p>Kriteri 3 Personeli akademik angazhohet në punën kërkimore shkencore për realizimin e programeve të studimeve;</p> <p>Kriteri 4 Puna kërkimore e personelit akademik të angazhuar për realizimin e programit të studimeve përkon me synimet për arritjen e qëllimeve të tij.</p>	<p>Kriteri 1 Programi i studimit është i fokusuar kryesisht në aftësimin profesional për plotësimin e komperencave në fushën e laboratorit mjekësor; megjithatë, përgatitja e mikrotezës e udhëhequr nga drejtues shkencor të kualifikuar i jep studentit dhe një eksperiencë fillestare që i shërben si guidë për punën dhe kërkimin shkencor.</p> <p>Kriteri 2 Programi i studimit është hartuar në përputhje me profilin e Institucionit të Arsimit të Lartë dhe strategjinë e tij për zhvillim</p> <p>Kriteri 3 Personeli akademik është i angazhuar jo vetëm në mësimdhënie por edhe në kërkim shkencor. Dëshmi e këtij aktiviteti është botimi i artikujve shkencorë, pjesmarrja në konferenca etj.</p> <p>Kriteri 4 Niveli i kualifikimit të personelit akademik dhe promovimi personal i tij përmes përfshirjes në projekte kërkimore është në koherencë me misionin dhe objektivat e programit të studimit.</p>
<p>Standardi I.7 - Programet e studimeve “Master Profesional” ofrohen në përputhje me nevojat e tregut të punës.</p>	

<p>Kriteri 1 Programet e studimeve të ciklit të dytë “Master Profesional” ofrohen në përputhje me nevojat e tregut të punës;</p> <p>Kriteri 2 Programet e studimeve të ciklit të dytë “Master Profesional” synojnë të plotësojnë nevojat në sektorët përkatës të ekonomisë vendase apo të huaj.</p>	<p>Kriteri 1 Programi i studimit të ciklit të dytë “Master Profesional” ofrohet në përputhje me nevojat e tregut të punës; sistemi laboratorik kërkon personel të mirë trajnuar me kompetencë për të përballuar sfidat teknologjike të kohës.</p> <p>Kriteri 2 Programi i studimit plotëson nevojat e tregut të punës për Teknikë të Lartë të Laboratorit Mjekësor për sektorin publik dhe privat; studentët mund të integrohen dhe në tregun e punës rajonal.</p>
Standardi I.8 - Programet e studimeve marrin parasysh nevojat e tregut të punës.	
<p>Kriteri 1 Programet e studimeve marrin parasysh nevojat e tregut të punës, dhe hartohen në përputhje me synimet strategjike të zhvillimit ekonomik kombëtar;</p> <p>Kriteri 2 Institucioni, për vlerësimin e nevojave të tregut të punës, kryen një studim tregu, i cili përfshin:</p> <ol style="list-style-type: none"> a. mundësitë e punësimit të studentëve në tregun vendas ose atë rajonal, komëtar a ndërkombëtar; b. kërkesat e punëdhënësve; c. një parashikim të përafërt për numrin e pritshëm të studentëve që mund të regjistrohen në këtë program; d. numrin e të regjistruarve në programe të ngjashme në institucionet simotra. 	<p>Kriteri 1 Programi ka marrë në konsideratë nevojat e tregut të punës të sektorit laboratorik mjekësor për teknikë të lartë të kualifikuar dhe me kompetence profesionale.</p> <p>Kriteri 2 Nevojat e tregut të punës janë studiuar me përgjegjësi nga institucioni dhe janë paraqitur në dokumentin “Plan Marketingu”.</p>
Standardi I.9 - Programet e studimeve synojnë ruajtjen e vlerave kulturore kombëtare dhe interesave kombëtare.	
<p>Kriteri 1 Institucioni ofron programe studimi që nuk bien ndesh me interes kombëtare;</p> <p>Kriteri 2 Programet e studimeve synojnë të ndihmojnë ruajtjen e vlerave kulturore kombëtare.</p>	<p>Programet e studimit që ofron KU Logos nuk bien ndesh me interesat kombëtare;</p> <p>Programi i studimit synon të ruajë vlerat kombëtare.</p>
Standardi I.12 - Kohëzgjatja dhe numri i krediteve për programet e studimeve të këtij cikli janë në përputhje me me ligjin nr. 9741, datë 21.5.2007, “Për arsimin e lartë në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar.	
<p>Kriteri 1 Programet e studimeve “Master i Shkencave” realizohet me 120 kredite europiane ECTS, ku përfshihen 30-40 kredite europiane ECTS për projektin kërkimor dhe tezën që duhet përgatitur në përfundim të këtyre programeve të studimeve. Kohëzgjatja normale e tyre është 2 vite akademike;</p>	<p>Kriteri 1 Kriteri nuk aplikohet për këtë program studimi</p>
<p>Kriteri 2 Programet e studimeve “Master Profesional” realizohen me 60-90 kredite europiane ECTS. Kohëzgjatja normale e tyre është 1-1.5 (një deri në një vit e gjysmë) vite akademike.</p>	<p>Kriteri 2 Programi i studimit “Master Profesional” në Teknikë e Lartë në Laboratorë Mjekësorë e plotëson kriterin pasi realizohet në një kohëzgjatje 1 vit akademik me kohë të plotë me 60 kredite europiane ECTS.</p>

<p>Kriteri 3 Programet e integruara të studimeve të ciklit të dytë përfundojnë me marrjen e diplomës “Master i Shkencave”. Ato realizohen me jo më pak se 300 kredite europiane ECTS (360 kredite europiane ECTS për studimet në fushën e mjekësisë). Kohëzgjatja normale e programeve të integruara të studimeve është jo më pak se 5 vite akademike (6 vite për studimet në fushën e mjekësisë).</p>	<p>Kriteri 3 Kriteri nuk aplikohet për këtë program studimi</p>
<p>Standardi II.6 - Institucioni siguron menaxhimin efikas të informacionit në lidhje me programet e studimeve.</p>	
<p>Kriteri 1 Informacioni i ofruar për programet e studimeve, modulet dhe syllabuset është lehtësisht i konsultueshem për studentët;</p>	<p>Kriteri 1 Informacioni i ofruar për programet e studimit, modulet dhe syllabuset është lehtësisht i konsultueshëm nga studentët. Studentët referuan se janë njohur që në fillim me planin e studimit dhe gjithë elementët e rëndësishëm të programit.</p>
<p>Kriteri 2 Informacioni për programet e studimit, modulet dhe syllabuset ofrohet në forma të ndryshme të shkruara dhe elektronike.</p>	<p>Kriteri 2 Informacioni për programet e studimit, modulet dhe syllabuset ofrohet në rrugë elektronike (faqja web), por dhe nga Zyra e Këshillimit të Karrierës, NJBSC, fushatat e marketingut, fletëpalosjet etj.</p>
<p>Standardi II.8 - Programet e studimeve të ciklit të dytë dhe programet e integruara të studimeve të ciklit të dytë parashikojnë një plan diplomimi.</p>	
<p>Kriteri 1 Plani i diplomimit shpjegon mënyrën e diplomimit në përfundim të studimeve brenda afatit të parashikuar;</p> <p>Kriteri 2 Për realizimin e programeve të studimeve “Master i Shkencave” janë parashikuar 30-40 kredite për projektin kërkimor dhe tezën.</p>	<p>Kriteri 1 Institucioni ka të përshkruar në rregulloren e studimeve “Master Profesional” planin, kushtet dhe kërkesat e diplomimit si dhe ka të parashikuara afatet përkatëse.</p> <p>Kriteri 2 Kriteri i paaplikueshëm pasi institucioni aplikon për Master Profesional provim përfundimtar.</p>
<p>Konkluzionet e vlerësimit:</p>	
<ol style="list-style-type: none"> 1. Programi i studimit “Master Profesional” në Teknikë e Lartë në Laboratorë Mjekësorë është paraqitur i plotë dhe i qartë. Përgjithësisht, kriteret janë të plotësuara si në tërësi ashtu dhe elementë të vecantë. 2. Programi i studimit është në përputhje me misionin dhe objektivat specifike si dhe përshtatet me nevojat e tregut të punës. Programi është strukturuar në përputhje me aktet ligjore në fuqi si dhe direktivat e BE për arsimin e lartë. Ai realizohet në kohëzgjatje normale prej një viti dhe 60 ECTS. Një pjesë e rëndësishme e planit mësimor është praktika profesionale pranë qendrave mjekësore që garanton aftësimin praktik profesional. 3. Në planin mësimor vërehet llogaritje e njëjtë e krediteve për forma të ndryshme të mësimdhënies. Është ruajtur i njëjti raport punë në auditor/punë e pavarur për leksionet, seminarët apo laboratorët. 4. Lëndë me numër të njëjtë orësh në auditor janë vlerësuar me numër të ndryshëm kreditesh. 5. Syllabuset janë në përputhje me misionin dhe objektivat e programit të studimit. Grupi i vlerësimit sugjeron formatimin e syllabuseve dhe rishikimin e emërtimit për një prej lëndëve. 6. Personeli akademik që mbulon programin “Master Profesional” përbëhet përgjithësisht nga personalitete me eksperiencë dhe kualifikim të lartë profesional në fushat përkatëse. <i>Në dy raste fusha e ekspertizës së pedagogut nuk përputhet me syllabusin e lëndës.</i> 7. Rekomandim: Grupi i vlerësimit sugjeron rishikimin e llogaritjes së krediteve shpërndarjes së tyre në raport me format e mësimdhënies si dhe një rishpërndarje më të mirë duke shtuar 	

Standardet janë përmbushur kryesisht

8. Mësimdhënia

Pjesa përshkrimore

Terma reference: organizimi i mësimdhënies, format e mësimdhënies, ngarkesa dhe cilësia e realizimit, kontrolli i njohurive të studentëve, metodat e mësimdhënies, teknologjitë e mësimdhënies, vlerësimi i brendshëm i mësimdhënies, aktivizimi i studentëve në komponentët e aktivitetit të njësisë etj.

Në rregulloren e programit “Master Profesional” në Teknikë e Lartë në Laboratorë Mjekësorë dhe në planin mësimor e syllabuset e lëndëve/moduleve janë përcaktuar qartë organizimi dhe mënyra e funksionimit të mësimdhënies. Jepen të detajuara format e mësimdhënies, ngarkesa në orë dhe ETCS, mënyrat e kontrollit të dijes etj. Institucioni parashikon dhe mënyrën dhe metodat e vlerësimit të brendshëm të mësimdhënies nga NJBSC dhe koordinatori i programit. Teknologjia dhe paisja e laboratorëve me aparatura dhe mjete didaktike në mbështetje të mësimdhënies është e mjaftueshme, cilësore dhe brenda standarteve bashkëkohore. Shpërndarja e ngarkesës mësimore është ndërtuar duke respektuar kërkesat e Ligjit të Arsimit të Lartë.

Vlerësimi i Treguesve të matshëm:

- Llojet e Formave të mësimdhënies, për lëndët/modulet:
 - Leksione – 280 orë
 - Seminare – 140 orë
 - Laboratore – 120 orë
 - Praktikë profesionale – 60 orë
 - Projekt kërkimor dhe Mikrotezë

Programi studimor ka parashikuar format e mësimdhënies. Orët totale në auditor dhe raportet për secilën lëndë të formave të ndryshme të mësimdhënies janë evidentuar në syllabuset e lëndëve/moduleve dhe në planin mësimor. Në planin mësimor llogariten 570 orë totale në auditor. Këto të dhëna nuk përputhen me të dhënat e syllabuseve të vecanta, dhe me tabelat e RVB ku orët totale llogariten 650. Të dhënat e paraqitura në tabelën 14 të RVB nuk përkojnë me të dhënat e planit mësimor.

- Format e kontrollit të njohurive

Në cdo lëndë pasqyrohen qartë format e kontrollit të njohurive. Për shumicën e lëndëve ato janë të unifikuara dhe përmbajnë:

- Vlerësimin për pjesmarrjen aktive 10%
- Testimet e pjesshme vjetore të njohurive teorike-praktike 30%
- Provimin përfundimtar 60%

- Aktivizimi i studentëve në komponentët e aktivitetit të njësisë etj

Aktivizimi i studentëve në projektet shkencore të institucionit dhe të pedagogëve është një nga detyrat e institucionit. KU Logos ka organizuar konferencën studentore me qëllim promovimin e punimeve që

studentët kanë bërë në bashkëpunim me pedagogët e tyre në rang departamenti po dhe jashtë tij. Punimet janë publikuar në Revistën e Studentëve të KU Logos.

Dokumentacioni përkatës i marrë në vizitat në institucion

Në institucion u njohëm me revistat e publikuara nga KU Logos me përmbledhje të punimeve të vetë studentëve si dhe me revistat me punime të konferencave shkencore.

9. Studentët

Pjesa përshkrimore

Terma reference: procedurat e pranimit të studentëve, cilësia në hyrje e studentëve, numri i studentëve në hyrje dhe në dalje në vite, koha mesatare e zgjatjes së studimeve, kalueshmëria e studentëve dhe problemet që lidhen me të, statistika, punësimi i të diplomuarve, komunikimi me ish-studentët e diplomuar, informimi i studentëve.

Procedurat e pranimit të studentëve janë parashikuar më rregulloren e programit të studimit dhe në rregulloren e statutit të institucionit. Meqenëse numri i studentëve në këtë program studimi është i vogël (regjistruar 9 studentë në vitin akademik 2013 – 2014 dhe 12 studentë në vitin akademik 2014 – 2015, 23 studentë në vitin akademik 2015 – 2016 dhe 35 studentë në vitin akademik 2017 – 2018) përzgjedhja e studentëve mbështetet në kritere të shpallura e të publikuara. Në listën e kriterëve gjykojmë pa sens zotërimin e titujve pasuniversitare, pasi titujt fitohen pas përfundimit të tre cikleve të studimit përfshi dhe doktoraturën.

Në raportin e analizës vjetore për vitin 2016 – 2017 është bërë një vlerësim i detajuar i rezultateve të procesit mësimor për të tre vitet e programit Bachelor dhe një përpunim i të dhënave për ciklin e studimeve Master Profesional në Teknikë e Lartë në Laboratorë Mjekësorë. Shifrat e kalueshmërisë janë të larta 92 – 93%. Bie në sy nota mesatare mjaft e lartë e studentëve që e kanë përfunduar ciklin e studimit me temë diplome (9.5 në vitin shkollor 2015 – 2016 dhe 9.8 në vitin shkollor 2016 – 2017) kundrejt një note mesatare të ulët për studentët që kanë përfunduar ciklin e studimeve me provim (5.62 në vitin shkollor 2015 – 2016 dhe 6.6 në vitin shkollor 2016 – 2017). Numri në rritje i regjistrimeve si dhe kalueshmëria e lartë janë tregues të interesit që kanë studentët për këtë program studimi.

Përmes një anketimi (mëteriali na u vu në dispozicion pas vizitës në institucion) KU Logos është përpjekur të krijojë një database për punësimin e studentëve të ciklit të parë dhe të programit Master Profesional në Teknikë e Lartë në Laboratorë Mjekësorë. Nga studentët e kontaktuar që kanë përfunduar programin Master Profesional 50% rezultojnë të punësuar. Rezultatet janë në plotësim dhe përpunim pasi nga informacionet që institucioni ka, rreth 90% e studentëve që kanë përfunduar Masterin Profesional janë të punësuar.

KU Logos mban komunikim me ish studentët e diplomuar; në nëntor 2017 është organizuar dhe rrjeti ALUMNI Logos (dokumenti na u vu në dispozicion në takim në institucion). Këshilli studentor dhe Zyra e Këshillimit të Karrierës luajnë rol të rëndësishëm në informimin e studentëve dhe këshillimin e tyre. Këto elementë janë parashikuar në dokumentet rregullatore të institucionit pranë Zyrës së Këshillimit të Karrierës. Dokumentacioni na u vu në dispozicion gjatë vizitës në institucion.

Vlerësimi i Tregues të matshëm:

Procedurat e pranimit të studentëve

Procedurat specifike të pranimit të studentëve në programin “Master Profesional” në Teknikë e Lartë në Laboratorë Mjekësorë janë të parashikuara qartë në rregulloren e këtij programi. Procedurat

parashikojnë konkurimin me dosje dhe intervistën e pranimit. Kushti kryesor është mbajtja e diplomës universitare Bachelor të fushës ose fushave të përafërta me programin. Në takimin në institucion GVI u njoh me procedurën dhe vendimin e pranimit të studentëve në vitin akademik 2017 – 2018 (dokumenti na u vu në dispozicion).

Cilësia në hyrje dhe në dalje e studentëve

Vlerësimi i cilësisë së studentëve në hyrje dhe dalje të programit të studimit realizohet duke marrë në konsideratë dhe duke krahasuar rezultatet e arsimit të mesëm me rezultatet e studentit të diplomuar. Në tabelën e paraqitur në RVB për tre vitet e studimit (2013 – 2014, 2014 – 2015 dhe 2015 – 2016) nota mesatare është 7.23 – 8.16. Nota mesatare është e lartë krahasuar me notën e provimit përfundimtar; kjo e dhënë demonstron rëndësinë që i jepet në programin master profesional vlerësimit të mësimin praktik - laboratorik.

Studentë të regjistruar në vitin e Parë (për herë të parë). Nota Mesatare (Plotësoni Tabelën në Aneks)

- 10 studentë në vitin akademik 2013 – 2014
- 11 studentë në vitin akademik 2014 – 2015
- 23 studentë në vitin akademik 2015 – 2016
- 35 studentë në vitin akademik 2017 – 2018 (programi me 60 ECTS)

Studentë të diplomuar në vitin e fundit (pa vite përsëritëse). Nota Mesatare

Nuk ka të dhëna për studentët e diplomuar në vitin e fundit (viti nuk ka përfunduar). Të dhënat për notën mesatare janë si më poshtë:

- 8.16 në vitin 2013 – 2014
- 7.23 në vitin 2014 – 2015
- 8.05 në vitin 2015 – 2016

Mobiliteti i studentëve brenda sistemit të arsimit të lartë në vend

Institucioni parashikon mobilitet të studentëve drejt institucioneve të tjera ose nga institucionet e tjera në vend. Bashkëpunimi me zyrën e ERASMUS + ka shtuar mundësitë për mobilitet të studentëve dhe të stafit akademik.

Të dhëna për punësimin e studentëve

KU nuk ka ende një databasë të plotë për punësimin e studentëve. KU Logos është përpjekur të krijojë një database për punësimin e studentëve të ciklit të parë dhe të programit Master Profesional në Teknikë e Lartë në Laboratorë Mjekësorë. Nga studentët e kontaktuar që kanë përfunduar programin Master Profesional 50% rezultojnë të punësuar. Rezultatet janë në plotësim dhe përpunim pasi nga informacionet që institucioni ka, rreth 90% e studentëve që kanë përfunduar Masterin Profesional janë ta punësuar.

Numri total të diplomuarve

Nuk ka të dhëna në raportin e vetëvlerësimit pasi është viti i parë që aplikohet ky program studimi me 60 ECTS.

Nuk ka të dhëna në raportin në lidhje me nr e të punësuarve.

Vlerësimi sipas Standardeve

Standardi/Kriteret	Vlerësimi sipas standardeve
Standardi IV.1 - Studentët kanë të drejtë të ndjekin programet e studimeve të ciklit të dytë dhe programet e integruara të studimeve të ciklit të dytë.	
<p>Kriteri 1 Studentët që ndjekin programet e studimeve “Master i Shkencave” apo “Master Profesional” zotërojnë së paku diplomën universitare “Bachelor” dhe kanë grumbulluar 180 kredite ECTS;</p> <p>Kriteri 2 Pranimi në programet e integruara të studimeve bëhet në përputhje me ligjin nr. 9741, datë 21.5.2007, “Për arsimin e lartë në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar dhe akteve nënligjore në fuqi;</p>	<p>Kriteri 1 Nga verifikimi i dokumentacionit që GVJ kishte në dispozicion dhe takimet që zhvilluam në IAL, konstatuam se, studentët që ndjekin programin e studimit “Master Profesional” në Teknikë e Lartë në Laboratorë Mjekësorë, zotërojnë së paku diplomën universitare “Bachelor” dhe kanë grumbulluar 180 kredite ECTS.</p> <p>Kriteri 2 Ky kriter nuk aplikohet për këtë program studimi.</p>
<p>Kriteri 3 Studentët plotësojnë kriteret e pranimit të përcaktuara nga institucioni;</p> <p>Kriteri 4 Studentët e këtyre programeve të studimit japin deri në diplomim edhe provimin e gjuhës angleze mbi bazën e testeve të njohura ndërkombëtare. Për programet e studimeve “Master Profesional” niveli i gjuhës angleze është B2, ndërsa për programet e studimeve “Master i Shkencave” dhe programet e integruara të studimeve të ciklit të dytë niveli i gjuhës angleze është C1, sipas Kuadrit European të Gjuhëve;</p> <p>Kriteri 5 Institucioni vlerëson herë pas here politikën e pranimit dhe ndikimin e tyre në përparimin e mëtejshëm të studentëve në programin e studimit, si dhe harton plane të mundshme për ndryshimin e kriterëve të pranimit.</p>	<p>Kriteri 3 Institucioni ka përcaktuar kriteret dhe procedurën të qarta për pranimin e studentëve në statutin dhe rregulloren e programit të studimit.</p> <p>Kriteri 4 Studentët e programit të studimit “Master Profesional” janë informuar që mbrojtja e gjuhës së huaj nuk është kusht për marrjen e diplomës.</p> <p>Kriteri 5 Institucioni është i angazhuar të rishikojë politikën e pranimit në funksion të përparimit të mëtejshëm të studentëve në programin e studimit.</p>
Standardi IV. 2- Institucioni informon studentët në lidhje me: statusin e institucionit, të programeve të studimeve që ofron dhe me politikën e punësimit.	
<p>Kriteri 1 Studentëve u jepet informacion për mundësitë për punësim pas diplomimit në përfundim të këtyre programeve të studimeve;</p> <p>Kriteri 2 Studentëve u jepet informacion për akreditimin e institucionit dhe të programeve të studimeve që ofrohen si edhe për njohjen dhe vlefshmërinë, brenda dhe jashtë vendit, të diplomës së lëshuar nga ky institucion;</p> <p>Kriteri 3 Studentëve u ofrohet shërbimi i këshillimit të karrierës.</p>	<p>Kriteri 1 Institucioni ka ngritur Zyrën e Këshillimit të Karrierës që iu jep informacion studentëve për mundësitë e punësimit. Praktika profesionale në klinika e laboratorë i njeh direkt studentët me kërkesat e punësimit. Gjatë takimeve na tha që kishte pasur disa raste kur studentët ishin punësuar në laboratorët që kishin realizuar praktikën.</p> <p>Kriteri 2 Studentët janë të informuar për fazat e akreditimit institucional dhe të programeve Bachelor në Teknikë e Lartë në Laboratorë Mjekësorë, si dhe për aplikimin për akreditim të programit të studimit “Master Profesional” në Teknikë e Lartë në Laboratorë Mjekësorë. Përfaqësues të studentëve janë pjestarë të grupit</p>

	<p>të vetëvlerësimit që përgatit raportin e vlerësimit të brendshëm për procesin e akreditimit të programit në fjalë. Studentët informohen dhe për vlefshmërinë e programit të studimit brenda e jashtë vendit. Kjo u konstatua dhe gjatë bisedës që grupi i vlerësimit të jashtëm realizoi me studentët.</p> <p>Kriteri 3 Me vendim të Senatit të SHLP Logos, që nga fillimi i vitit akademik 2014 – 2015, funksionon Zyra e Këshillimit të Karrierës që siguron informacion dhe trajnime për studentët. Kjo zyrë organizonte edhe takime me studentët, ku ata njiheshin me konferencat apo aktivitetet e tjera që mund të organizonte IAL.</p>
--	---

Standardi IV. 3- Institucioni, kur aplikon për vlerësimin dhe akreditimin për herë të dytë, disponon statistika në lidhje me numrin e studentëve që ndjekin programet e studimeve të ciklit të dytë dhe programet e integruara të studimeve të ciklit të dytë.

<p>Kriteri 1 Institucioni disponon statistika vjetore për numrin e të diplomuarve në programet e studimeve që kanë përfunduar;</p> <p>Kriteri 2 Institucioni disponon statistika vjetore për numrin e studentëve të regjistruar në programet e studimeve të ciklit të dytë dhe në programet e integruara të studimeve të ciklit të dytë, tërheqjet nga programi, si dhe largimet para përfundimit të programit apo mospërfundimin me sukses të vitit akademik;</p> <p>Kriteri 3 Institucioni disponon të dhëna për ecurinë akademike të studentëve që nga pranimi deri në diplomim.</p>	<p>Kriteri 1 Institucioni disponon statistika vjetore për numrin e të diplomuarve në programet e studimeve që kanë përfunduar. Programi i studimit “Master Profesional” në Teknikë e Lartë në Laboratorë Mjekësorë është në proces akreditimi pas riorganizimit të tij në 60 ECTS. Për vitin 2017 – 2018 në këtë program ka student të regjistruar (studentët nuk mund të diplomohen pa u akredituar program).</p> <p>Kriteri 2 Institucioni disponon statistika për numrin e studentëve të regjistruar në programin e studimit “Master Profesional” në Teknikë e Lartë në Laboratorë Mjekësorë. Nga vizita në IAL u vërtetua që nr i studenteve të rregjistruar përputhej me të dhënat e deklaruara në RVB.</p> <p>Kriteri 3 Institucioni disponon një bazë të plotë të dhënash për ecurinë akademike të studentëve që nga momenti i regjistrimit. Për vitin në vazhdim të dhënat nuk janë të plota pasi nuk ka përfunduar diplomimi.</p>
--	---

Standardi IV. 4- Institucioni disponon një bazë të dhënash në lidhje me statistikën e punësimit të studentëve që janë diplomuar pas përfundimit të programeve të studimeve të ciklit të dytë dhe programeve të integruara të studimeve të ciklit të dytë.

<p>Kriteri 1 Institucioni mban një bazë të dhënash të studentëve të punësuar pas përfundimit të programeve të studimeve të ciklit të dytë apo të programeve të integruara të studimeve të ciklit të dytë si dhe për vendet e punësimit të tyre;</p> <p>Kriteri 2 Institucioni mban një bazë të dhënash për studentët që vazhdojnë studimet e mëtejshme në ciklet e tjera të studimeve etj.</p>	<p>Kriteri 1 Programi i studimit “Master Profesional” në Teknikë e Lartë në Laboratorë Mjekësorë me 60 ECTS nuk ka ende një brez të diplomuar ndaj nuk disponon të dhëna lidhur me punësimin. Për programin Master profesional me 90 ECTS institucioni ka krijuar një database të pjesshme që është në përditësim.</p> <p>Kriteri 2 Institucioni disponon një databasë më</p>
--	---

	të plotë të dhënash për programin e studimit Bachelor e cila u verifikua edhe gjatë vizitës që GVJ pati në institucion.
Standardi IV. 5- Institucioni informon studentët në mënyrë të vazhdueshme dhe të detajuar, në lidhje me programet e studimeve.	
<p>Kriteri 1 Studentët informohen në mënyrë të detajuar për programet e studimeve, afatin e përfundimit dhe organizimin e programit, statusin e akreditimit të programit;</p> <p>Kriteri 2 Studentët informohen për rezultatet e vlerësimit gjatë dhe në përfundim të programit;</p> <p>Kriteri 3 Përgjegjësi i modulit diskuton hapur me studentët rezultatet e këtyre vlerësimeve.</p>	<p>Kriteri 1 Studentët janë informuar në mënyrë të detajuar për përmbajtjen e programit të studimit “Master Profesional” në Teknikë e Lartë në Laboratorë Mjekësorë, afatin e përfundimit, mënyrën e organizimit studin e procesit të akreditimit kjo na u tha gjatë takimit që patëm me studentët e këtij programi studimi.</p> <p>Kriteri 2 Rezultatet e vlerësimit të pjesshëm ose përfundimtar iu bëhen të njohura studentëve brenda afatit të përcaktuar; shpallja e rezultatit final bëhet vetëm pas procedurës së ankimimit.</p>
	Kriteri 3 Rezultati i provimit i komunikohet studentit nga përgjegjësi i modulit.
Standardi IV. 6- Institucioni angazhon personelin e tij për përkujdesjen ndaj studentëve.	
<p>Kriteri 1 Institucioni u ofron këshillim studentëve, ndjek ecurinë e tyre dhe i ndihmon për trajtimin dhe zgjidhjen e çështjeve dhe problematikave që lidhen me procesin mësimor;</p> <p>Kriteri 2 Institucioni (nëpërmjet zyrës për këshillimin e karrierës) ndihmon studentët në përzgjedhjen e institucionit në të cilin ata do të zhvillojnë praktikën profesionale, në rastet kur parashikohet një e tillë.</p>	<p>Kriteri 1 Në funksion të këshillimit të studentëve, asistencës për problematika që lidhen me procesin mësimor, në KU Logos funksionon jo vetëm Zyra e Këshillimit të Karrierës por dhe Zyra e Etikës dhe Qendra e Kërkimit Shkencor. Në këtë proces janë të përfshirë aktivisht dhe anëtarët e stafit akademik. Për ecurinë në praktikën profesionale, studentët monitorohen dhe mbështeten nga pedagogu përgjegjës i praktikës.</p> <p>Kriteri 2 Institucioni (nëpërmjet zyrës për këshillimin e karrierës) orienton studentët, duke vlerësuar dhe preferencat e tyre, për qëndrën mjekësore ku do të kryejnë praktikën profesionale.</p>
<u>Konkluzionet e vlerësimit:</u>	
<ol style="list-style-type: none"> 1. Informacioni në lidhje me studentët që ndjekin programin e studimit “Master Profesional” në Teknikë e Lartë në Laboratorë Mjekësorë është i evidentuar qartë në statutin dhe rregulloren e KU Logos si dhe në rregulloren e programit të studimit “Master Profesional” në Teknikë e Lartë në Laboratorë Mjekësorë. 2. Studentët janë vazhdimisht nën kujdesin e stafit akademik dhe Zyrës së Këshillimit të Karrierës lidhur me komponentët e procesit mësimor dhe të punësimit të ardhshëm. Studentët mbikqyren dhe kanë mbështetjen e pedagogut përgjegjës gjatë kryerjes së praktikës profesionale. 3. Studentët janë të informuar dhe marrin pjesë aktive (me përfaqësuesin e tyre në grupin e vetëvlerësimit) në procesin e akreditimit të programit. 4. Në institucion funksionon rrjeti ALUMNI Logos dhe Këshilli studentor që japin ndihmesën e tyre në mbarëvajtjen e procesit mësimor dhe në zgjerimin e informacionit për tregun e punës dhe mundësitë e mobilitetit. 5. Institucioni përgatit raporte vjetore për arritjet dhe problematikat e procesit mësimor, të 	

- paisur me tabela dhe grafikë për vitin dhe krahasuese mes vitesh.
6. Institucioni ka krijuar një database për punësimin e studentëve.

Standardet janë përmbushur plotësisht

KËRKIMI SHKENCOR NË FUNKSION TË PROGRAMIT TË STUDIMIT.

10. Kërkimi shkencor

Pjesa përshkrimore

Terma reference: politikat e kërkimit shkencor në këtë program studimi, botimet në vite, projektet e fituara dhe të realizuara, pjesëmarrja në aktivitetet brenda dhe jashtë vendit, aktivitetet e organizuara nga njësia, lidhja e kërkimit me mësimdhënien.

Një komponent i rëndësishëm i parashikuar dhe i synuar nga KU Logos është dhe kërkimi shkencor. Megjithëse synimi kryesor i programit të studimit “Master Profesional” në Teknik i Lartë Laboratorësh Mjekësorë është aftësimi profesional, institucioni inkurajon dhe orienton stafin drejt kërkimit shkencor, botimeve, pjesëmarrjes në aktivitete shkencore etj. Përfshirja në projekte kërkimore në fushën e mjekësisë laboratorike është një synim afatgjatë i institucionit që mendohet të realizohet përmes bashkëpunimit me institucione të tjera të fushës brenda dhe jashtë vendit.

Vlerësimi i Treguesve të matshëm:

- Të dhëna për kërkimin shkencor

Institucioni ka vënë në dispozicion të GVJ të dhënat lidhur me kërkimin shkencor, tabelat përkatëse, numrin e botimeve për cdo pedagog, materialet e konferencave të organizuara etj.

- Numri i botimeve nga personeli akademik efektiv i IAL

22 botime si poster ose artikuj në revista shkencore ku stafi efektiv ka qenë autor ose bashkautor.

- Numri i aktiviteteve shkencore të organizuara nga IAL

2 konferenca shkencore në fushën e Mjekësisë Laboratorike të organizuara gjatë dy viteve të fundit.

- Numri i pjesëmarrësve në aktivitete shkencore brenda IAL

40 (dyzet), të cilët kanë qenë kryesisht staf dhe studentë të IAL dhe një pjesë lektorë të ftuar nga institucione të tjera të arsimit të lartë vendas dhe të huaj.

- Numri i kërkimit shkencor me procesin mësimor

5 (pesë) sipas verifikimit në institucion ky numër i përkët personelit të Qëndës së Kërkimit dhe Zhvillimit të përfshirë në procesin mësimor.

- Numri i studentëve të përfshirë në kërkimin shkencor

64 (gjashtëdhjetë e katër) sipas verifikimit në institucion ky numër i përkët studenve të cilët janë angazhuar kryesisht në pjesën organizative të aktiviteteve shkencore dhe jo në mënyrë të drejtpërdrejtë në kërkim shkencor.

Numri i Çmimeve Kombëtare

Nuk ka

Dokumentacioni përkatës i marrë në vizitat në institucion
Të dhënat janë marrë nga RVB dhe nga informimi prej stafit të institucionit, na janë vënë në dispozicion: tabelat përkatëse me numrin e botimeve për cdo pedagog, librat e botuara nga stafi, materialet e konferencave të organizuara, dokumenta në lidhje me strategjinë e financimit të kërkimit shkencor në të ardhmën etj.

Vlerësimi sipas Standardeve

Standardi/Kriteret	Vlerësimi sipas standardeve
Standardi III.3 - Personeli akademik angazhohet në veprimtari shkencore të organizuara në kuadër të programit të studimeve.	
Kriteri 1 Personeli akademik publikon rregullisht artikuj, materiale shkencore në disipinën përkatëse; Kriteri 2 Personeli akademik, nëpërmjet angazhimeve në këto veprimtari jep ndihmesën e tij në zhvillimin e shkencës ose në zhvillimin e sektorëve të prodhimit apo të shërbimit.	Kriteri 1 Nga informacioni dhe dokumentacioni në dispozicionin tonë rezulton se personeli akademik publikon artikuj dhe postera shkencorë si dhe merr pjesë në konferenca shkencore ndërkombëtare. Kriteri 2 Personeli akademik i angazhuar në programin e studimit Master Profesional në Teknik i Lartë Laboratorësh Mjekësorë ka dhënë dhe jep ndihmesë aktive në zhvillimin e sektorit laboratorik mjekësor e privat në Shqipëri. Publikimet dhe angazhimi i stafit në punë kërkimore-shkencore kontribuojnë në zhvillimin e shkencave biomjekësore. Organizimi i konferencave shkencore është një kontribut i rëndësishëm në këtë drejtim.
Standardi III.4 - Institucioni ofron programe mësimdhënieje edhe në gjuhë të huaj, me një personel akademik të kualifikuar.	
Kriteri 1 Personeli akademik që angazhohet në mësimdhënie në gjuhë të huaj ka kryer studimet universitare në atë gjuhë ose zotëron një certificate për njohje të avancuar të saj; Kriteri 2 Personeli akademik që angazhohet në mësimdhënie në gjuhë të huaj ka një përvojë në mësimdhënie në atë gjuhë, prej së paku një semestri.	Kriteri 1 Në KU Logos nuk jepen mësimet në gjuhë të huaj në lëndët profesionale vec mësimet të gjuhës angleze dhe greke që mbulojnë nga pedagogë të huaj dhe vendas me diplomë universitare të fushës. Kriteri 2 Gjuha e vetme në të cilën ofrohet mësimdhënia është gjuha shqip.
Standardi III.10 - Institucioni angazhohet për kualifikimin e vazhdueshëm dhe të mëtejshëm të personelit të tij.	
Kriteri 1 Institucioni organizon programe specifike për kualifikimin e mëtejshëm profesional të personelit akademik e të personelit mësimorshkencor; Kriteri 2 Institucioni u ofron personelit akademik dhe atij mësimor-shkencor mundësinë e kualifikimeve të mëtejshme brenda dhe jashtë vendit.	Kriteri 1 Institucioni parashikon kualifikime afatshkurtra profesionale në të ardhmen për pedagogët e rinj. Deri më tani nuk janë realizuar programe specifike kualifikimi. Kriteri 2 Institucioni mbështet kualifikimet e stafit jashtë vendit dhe ka institucionalizuar marrveshje bashkëpunimi në këtë fushë me universitete të huaja, por deri më tani këto

	marrëveshje nuk janë konkretizuar ende. Kjo na u tha gjatë takimeve që zhvilluam në institucion.
Standardi III.11 - Institucioni disponon një bazë të dhënash në lidhje me veprimtarinë kërkimore-shkencore të personelit akademik të tij.	
<p>Kriteri 1 Institucioni disponon një bazë të dhënash të studimeve shkencore të personelit akademik të angazhuar në këtë program studimi;</p> <p>Kriteri 2 Institucioni disponon një bazë të dhënash për botimet (tekste, monografi, libra, artikuj apo kumtesa në konferenca) brenda e jashtë vendit të personelit akademik të angazhuar në këtë program studimi;</p> <p>Kriteri 3 Institucioni disponon një bazë të dhënash për projektet kërkimore shkencore kombëtare e ndërkombëtare në të cilat ka marrë ose merr pjesë personeli akademik i angazhuar në këtë program studimi.</p>	<p>Kriteri 1 Institucioni disponon dosjet personale të anëtarëve të stafit akademik të cilat pasurohen kohë pas kohe. Nga vizitaqë bënë në zyrën e burimeve njerëzore pamë që dosjet e stafit ishin të plota, pasi ato përmbanin një sër dokumentash.</p> <p>Kriteri 2 Institucioni disponon bazën e të dhënave lidhur me botimet (CV, fotokopje publikimesh, depozitim i librave të publikuara në bibliotekë, certifikata të pjesëmarrjes ne aktivitete)</p> <p>Kriteri 3 Institucioni nuk ka bazë të dhënash për pjesmarrje në projekte kombëtare e ndërkombëtare. Aktualisht Qendra e Kërkimit dhe Zhvillimit është e angazhuar për evidentimin e aplikimeve për pjesmarrje. Me gjithatë gjatë takimeve që patëm në IAL na u tha se KU Logos është duke bërë përpjekje të vazhdueshme në këtë fushë.</p>
Konkluzionet e vlerësimit:	
<ol style="list-style-type: none"> 1. Institucioni paraqet disponibilitet dhe angazhim për të zhvilluar kërkim shkencor, inkurajon specializimet e pedagogëve të rinj, ka organizuar aktivitete shkencore ne fushen e mjekesisë laboratorike dhe është angazhuar në mundësinë e aplikimit për pjesmarrje në projekte shkencore në të ardhmen. 2. Institucioni ka një strategji të qartë dhe të integruar të kërkimit shkencor. 3. Meqënëse ende nuk ka rezultate konkrete në lidhje me marrëveshjet e bashkëpunimit me institucione të tjera universitare, rekomandojmë që në të ardhmen të punohet për konkretizimin e tyre. 	
Standardet janë përmbushur plotësisht	

11. Bashkëpunimi kombëtar, ndërkombëtar dhe marrëdhëniet me publikun

Pjesa përshkrimore

Terma reference: bashkëpunimi me institucionet e tjera në nivel lokal, kombëtar apo ndërkombëtar, mobiliteti i personelit akademik në secilin nga nivelet e sipërpërmendura, pjesëmarrja në programe kombëtare dhe ndërkombëtare, lidhjet me komunitetin e biznesit dhe me tregun e punës.

Në kuadër të rritjes së cilësisë së mësimdhënies dhe kërkimit shkencor, SHLP Logos ka vendosur mardhënie bashkëpunimi me universitet të tjera brenda dhe jashtë vendit si Universitetin Bujqësor në

Tiranë, Universitetin e Pireut në Greqi, Universitetin ndërkombëtar të Selanikut në Greqi, Universiteti Zonja e Keshillit të Mire, Universitatea di Oradea Rumani, Universiteti i Shkencave të Aplikuarë Greqi. Marrëveshjet parashikojnë mobilitet të personelit akademik dhe të studentëve, organizim të aktiviteteve të përbashkëta, pjesëmarrje në projekte kërkimore shkencore.

KU Logos ka lidhur marrëveshje bashkëpunimi dhe më disa qendra laboratorike mjekësore private për të mundur realizimin e praktikës profesionale dhe krijimin e kushteve për studimin e mikrotezës për studentët e programit të studimit “Master Profesional” në teknikë të Lartë Laboratorësh Mjekësorë. Deri me tani KU nuk ka marrëveshje bashkëpunimi me Institucione Qeveritare dhe me Organizata profesionale.

Vlerësimi i Treguesve të matshëm:

- Të dhëna për bashkëpunimin kombëtar dhe ndërkombëtar

Në funksion të kërkimit shkencor është ngritur Qendra e Kërkimit Shkencor pranë Fakultetit të Shkencave të Aplikuarë. Infrastruktura eksistuese janë vetëm laboratorët mesimorë të cilët janë në funksion të zhvillimit të programit mësimor.

- Numri i pjesëmarrësve në aktivitete shkencore Jashtë IAL/ jashtë vendit dhe prezantime 7 botime si poster ose artikuj në revista shkencore ku stafi efektiv ka qenë autor ose bashkautor
- Komunikimi dhe bashkëpunimi me institucionet e tjera shtetërore, organizata profesionale, komunitetin e biznesit, tregun e punës dhe aktorë të tjerë shoqërorë të rëndësishëm për arsimin e lartë:
 - Institucionet qeveritare bashkëpunuese
Nuk ka
 - Organizatat Profesionale
Nuk ka
 - Komuniteti i biznesit, tregu i punës
Laboratori Mjekësor Intermedica
Genius SHPK
Qendrën Orthodoxe Diagnostike “Ungjillëzimi”
Spitali Hygea
QSUT Nene Tereza
SU “Shefqet Ndroqi”

Institucioni ka marrëdhënie bashkëpunimi edhe me 8 (tete) klinika dhe laboratore mjekësore të tjera, të kapacitetit të vogël dhe të mesëm, me qëllim realizimin e praktikës profesionale të studentëve.

Të dhënat u morën nga RVB dhe nga verifikimi në institucion nuk u vunë re ndryshime.

- Dokumentacioni përkatës i marrë në vizitat në institucion
Gjatë vizitës në institucion u verifikua dokumentacioni i plotë i marrëveshjeve me institucionet e tjera të arsimit të lartë brenda dhe jashtë vendit, marrëveshjet e nënshkruara me aktore të biznesit dhe me klikat dhe laboratorët mjekësorë, botimet e stafit akademik etj.

Vlerësimi sipas Standardeve

Standardi/Kriteret	Vlerësimi sipas standardeve
Standardi V. 3- Institucioni ka marrëdhënie bashkëpunimi me aktorë të biznesit vendas apo të huaj për kryerjen e praktikave të studentëve të tij.	
<p>Kriteri 1 Për kryerjen e praktikave të ndryshme të parashikuara për realizimin e programit të studimeve “Master Profesional”, institucioni dëshmon se ka marrëdhënie bashkëpunimi me ndërmarrje apo sipërmarrje nga fusha e tregtisë, industrisë apo e shërbimeve prodhuese;</p> <p>Kriteri 2 Për kryerjen e praktikave të ndryshme në programin e studimeve “Master i Shkencave” ose në programet e integruara të studimeve të ciklit të dytë, institucioni dëshmon se ka marrëdhënie bashkëpunimi me aktorë të ndryshëm nga sfera publike dhe ajo private që mundësojnë përfitimin e njohurive më të mira profesionale nga ana e studentit.</p>	<p>Kriteri 1 Për kryerjen e praktikave të ndryshme të parashikuara për realizimin e programit të studimeve “Master Profesional”, institucioni ka marrëdhënie bashkëpunimi me Klinikën Orthodoke dhe disa klinika e laboratorë private. Marrëveshjet e bashkëpunimit u verifikuan si nga RBV ashtu edhe gjatë vizitës në vend. Marrëveshjet e bashkëpunimit, janë realizur me institucione, ku fusha e veprimtarisë së tyre, është në përputhje të plotë me qëllimin dhe objektivat e programit të studimit.</p> <p>Kriteri 2 I paaplikueshëm sepse KU Logos nuk ofron program studimi Master Shkencor.</p>
Standardi VII.1 - Institucioni garanton marrëdhënie të frytshme bashkëpunimi mes personelit të tij.	
<p>Kriteri 1 Institucioni, për hartimin dhe mbikëqyrjen e programit, nxit bashkëpunimin ndërmjet personelit brenda institucionit nëpërmjet shkëmbimit të informacionit;</p> <p>Kriteri 2 Institucioni, nëpërmjet ndarjes së detyrave mes personelit Brenda institucionit, marrjes së përgjegjësisë respektive dhe analizës së vazhdueshme të punës së tyre, garanton marrëdhënie të frytshme bashkëpunimi.</p>	<p>Kriteri 1 Institucioni inkurajon bashkëpunimin ndërmjet personelit për probleme të hartimit të programit e planit mësimor, realizimit të tij dhe kërkimit shkencor kryesisht përmes qendrës së Kërkimit Shkencor.</p> <p>Kriteri 2 Organizimi i punës në institucion bëhet në frymën e bashkëpunimit duke respektuar hierarkinë dhe statutin. Kjo frymë bashkëpunimi dhe gjithpjesmarrjeje u evidentua dhe gjatë vizitës së grupit të vlerësimit të jashtëm në institucion. Institucioni realizon Analizën vjetore të punës, e cila u verifikua nga dokumentacioni i vënë në dispozicion dhe gjatë vizitës në vend.</p>
Standardi VII.2 - Institucioni garanton marrëdhënie bashkëpunimi me institucionet homologe jashtë vendit dhe aktorët e biznesit vendas ose të huaj.	
<p>Kriteri 1 Institucioni për realizimin e objektivave të programeve të studimeve ka vendosur marrëdhënie bashkëpunimi me institucionet homologe jashtë vendit dhe aktorët e biznesit vendas ose të huaj;</p> <p>Kriteri 2 Institucioni vendos marrëdhënie bashkëpunimi me punëdhënësit për kryerjen dhe mbikëqyrjen e praktikës, në varësi të programeve të studimeve që ofron;</p> <p>Kriteri 3 Institucioni organizon trajnime profesionale të mëtejshme në bashkërendim me</p>	<p>Kriteri 1 Për realizimin e objektivave të programit Master Profesional në Teknik i Lartë Laboratorësh Mjekësorë, institucioni ka lidhur marrëveshje bashkëpunimi me institucione homologe brenda e jashtë vendit si dhe me aktorë biznesi.</p> <p>Kriteri 2 Institucioni ka marrëdhënie bashkëpunimi, një praktikë dhe rregullore të qartë për vlerësimin e praktikës profesionale të studentit nga punëdhënësi vec vlerësimit nga pedagogu mbikqyrës.</p> <p>Kriteri 3 Aktualisht institucioni nuk organizon trajnime profesionale por është i angazhuar për</p>

Mes. cat

<p>punëdhënësit;</p> <p>Kriteri 4 Institucioni bën një raport analitik të përfitimeve nga marrëveshjet kontraktuale në funksion të realizimit të programeve të studimeve.</p>	<p>aplikimin në të ardhmen.</p> <p>Kriteri 4 Institucioni ruan bazën e të dhënave të vlerësimit të studentit në praktikën profesionale.</p>
<p><u>Konkluzionet e vlerësimit:</u></p> <ol style="list-style-type: none"> 1. KU Logos ka marrëdhënie bashkëpunimi të konsoliduar me institucione shëndetësore të fushës laboratorike për kryerjen e praktikave profesionale të studentëve me teknologji të avancuar bashkëkohore. Po ashtu ky institucion ka marrëveshje bashkëpunimi me institucione homologe universitare brenda e jashtë vendit përmes të cilave inkurajon dhe promovon specializimin e pedagogëve të rinj dhe shkëmbimet e studentëve. 2. Deri më sot nuk janë realizur këmbime të stafit apo të studentëve me institucione të tjera universitare homologe. 3. Pjesa më e madhe e bashkëpunimeve ende nuk ka dhënë një rezultat konkret, <i>rekomandojmë që të punohet për konkretizimin e këtyre bashkëpunimeve.</i> 4. Vlerësojmë që infrastruktura në funksion të kërkimit shkencor në institucion nuk është e mjaftueshme dhe bashkëkohore, rekomandojmë në të ardhmen të punohet për përmirësime në këtë drejtim . <p>Standardet janë përmbushur kryesisht</p>	

ANALIZA PËRMBLEDHËSE PËR IMPLEMENTIMIN E PROGRAMIT TË STUDIMIT

RVJ mbyllet me “**Analizën përmbledhëse të RVJ**” sipas metodës SWOT (Strengths-pikat e forta, Weaknesses- pikat e dobëta, Opportunities-mundësitë, Threats-pengesat).

a. Pika të forta:

1. Programi i Studimit Master Profesional në Teknik i Lartë Laboratorësh Mjekësorë organizohet dhe realizohet në një institucion me eksperiencë dhe profilizim 14 vjeçar në fushën e përgatitjes së laborantëve dhe teknikëve të laboratorit me diplomë universitare Bachelor; tradita dhe vazhdimësia janë përparësi.
2. Baza laboratorike për aftësimin profesional për krijimin e specialistëve Teknikë të Lartë Laboratori me kompetencë reale profesionale është në nivele të mira; e plotësuar dhe me mjete didaktike, garanton realizimin me sukses të praktikave laboratorike.
3. Planet dhe programet mësimore janë hartuar në bazë të modeleve më të mira kombëtare, europiane e më gjerë duke respektuar standartet dhe kuadrin ligjor në fuqi.
4. Staf i përgjithshëm ka kualifikim dhe eksperiencë për realizimin e programit.
5. Vërehet organizim i mirë i brendshëm dhe mirëmenazhim.
6. Institucioni ka një politikë mbështetëse dhe inkurajuese për studentin. Ai i siguron studentit jo vetëm përgatitje teorike por dhe praktikë profesionale në institucione laboratorike në funksion të përgatitjes për tregun aktual dhe perspektiv të punës.
7. Institucioni ka një politikë mbështetëse për kërkimin shkencor që demonstron nga organizimi i konferencave shkencore me pjesëmarrje lektorësh shqiptarë e të huaj ashtu dhe nga mbështetja financiare që iu ka akorduar departamenteve për këtë qëllim.

b. Pika të dobëta:

1. Organizimi i syllabuseve dhe ndarja e krediteve sipas formave të mësimdhënies. Në ndarjen e krediteve nuk janë respektuar raportet e diferencuara orë në auditor/punë e pavarur sipas tipeve të mësimdhënies (leksion, laborator, seminar)
2. Mungesa e një sistemi të informatizuar në funksion të stafit dhe të studentëve
3. Angazhimi i ulët i stafit në projekte konkrete kërkimore shkencore dhe mungesa e një infrastrukture bashkëkohore të kërkimit shkencor.
4. Mospërputhja në ndonjë rast e fushës së ekspertizës së pedagogut me lëndët të cilat ata mbulojnë në këtë program studimi.

c. Mundësitë:

1. Funksionimi në përbërje të Fondacionit Logos i siguron KU mbështetje dhe garanci financiare
2. Vënia në eficiencë të plotë e laboratorëve, standartizimi, modernizimi dhe akreditimi i tyre për ta kthyer KU Logos konkurente reale në tregun e diagnozës laboratorike dhe të kërkimit shkencor në këtë fushë.
3. Implementimi i plotë i marrëveshjeve me universitetet jashtë vendit për kualifikim të stafit akademik dhe ofrim bursash për studentët kontribuon për një zhvillim institucional të qëndrueshëm.

d. Pengesat:

1. Mungesa e një tregu të konsoliduar e të rregulluar të arsimit të lartë jopublik
2. Pengesa relative për rekrutimin e personelit akademik me kohë të plotë me titull profesor ose profesor i asociuar; personeli i ri akademik i rekrutuar në shumicë është në prag ose proces të mbrojtjes së doktoraturës.
3. Tendencë në ulje të numrit të studenteve regjistruar.

e. Rekomandime

1. Rekomandojmë që lëndët të mbulohen nga personel akademik ku fusha e ekspertizës të përputhet me programin.
2. Laboratorët të pasurohen me pajisje bashkëkohore për të siguruar punë individuale të studentëve të nivelit master.
3. Përmirësimi i syllabuseve duke rishikuar shpërndarjen e krediteve në raport me format e mësimdhënies si dhe rishpërndarjen më të mirë duke shtuar peshën specifike të disiplinave të ngjashme dhe të integruara.
4. Të punohet për konkretizimin e marrëveshjeve të bashkëpunimit me institucione universitare homologe kombëtare dhe ndërkombëtare.

SWOT ANALYSIS

a. Strength:

1. Professional Master Study Program in *Medical Laboratory Technique* is organized and implemented in an institution with 14 years of experience and profiling with regard to the

preparation of laboratory technicians with a Bachelor's degree; Tradition and continuity are priorities.

2. The laboratory base for the vocational training of high *specialists in Medical Laboratory Technique* with a real professional competence is at good levels; supplemented by the didactic means, guarantees the successful realization of laboratory practices.
3. The curricula are designed based on the best national, European and wider models, while respecting the standards and legal framework in power.
4. Staff is generally qualified and experienced for the implementation of the program
5. Good internal organization and good management is noted.
6. The institution has a supportive and encouraging policy for the students. It provides the student not only with theoretical preparation, but practical training in institutional laboratories as well, in order to prepare for the current and prospective job market.
7. The institution has a supportive scientific research policy that is demonstrated by the organization of scientific conferences, the participation of Albanian and foreign lecturers in such conferences as well as by the financial support provided to departments for this purpose.

b. Weaknesses:

1. Organization of syllabuses and the allocation of credits according to the forms of teaching. In the distribution of hours for each credit, the ratio between hours in the auditorium and independent work has not been followed in accordance with the type of teaching (lecture, laboratory, seminar)
2. Lack of a computerized system for staff and students
3. Low staff engagement in concrete research projects and the lack of a modern scientific research infrastructure.
4. Discrepancy in some cases, between the expertise of a pedagogue with the subjects that they cover in this study program.

c. Opportunities:

1. Functioning within the Logos Foundation provides UC support and financial guarantee
2. Putting laboratories to work at full capacity, standardization, modernization and accreditation, with the purpose of transforming CU Logos into a real competitor in the market of laboratory diagnosis and research.
3. The full implementation of agreements with universities abroad for the qualification of academic staff and the provision of scholarships for students can contribute to a sustainable institutional development.

d. Threats:

1. Lack of a consolidated and regulated market of non-public higher education.
2. The relative obstacle to recruit full-time academic staff with a professor or associate professor title; the new recruited academic staff is primarily in due process of doctoral studies.
3. Decreasing tendency in the number of registered students.

e. Recommendations:

1. We recommend that all the subjects are covered by academic staff, whose field of expertise complies with the program.

2. The laboratories need to be enriched with contemporary equipment in order to enable individual work for master level students.
3. Improvement of the syllabus, by reviewing the distribution of hours per credits, in relation to teaching formats, and better distribution by adding specific weight to similar and integrated disciplines.
4. Working towards the implementation of cooperation agreements with homologous national and international university institutions.

Grupi i Vlerësimit të Jashtëm

Prof. As. Etleva Refatllari



Dr. Nevila Heta



Tabela 1: Numri i Personelit Akademik Efektiv (PAE) dhe me kontratë (PAK) në Fakultet

Fakulteti i Shkencave të Aplikuara	Numri i PAE		Numri i PAK		Në Total	
	Gj	Tituj/Grada	Gj	Tituj/Grada	Gj	Tituj/Grada
Departamenti Teknikë e Lartë në laboratore mjekësorë	7	1/3	3	2/1	9	3/4
Departamenti Informatikë e Zbatuar	8	2/0	3	1/1	11	3/1
Qendra për kërkim dhe zhvillim shkencor	5	2/1	0	0	5	2/1

Tabela 2: Lista e Personelit Akademik Efektiv (PAE) dhe me kontratë (PAK)

Fakulteti i Shkencave të Aplikuara Departamenti "Teknik i Lartë Laboratorësh Mjekësorë"							
Personeli Akademik Efektiv (Emër Mbiemër)		Detyra në Dep.	Titulli /Grada	Personeli Akademik me Kontratë (Emër Mbiemër)		Titulli /Grada	Institucioni ku punon full time
1	Aleksandër Sallabanda	Dekan	Prof.	1	Shpëtim Qyra	Prof. Asc.	ISHP
2	Ridvana Mediu	Përgj. Departamenti	Dr.	2	Alma Barbullushi	Prof. Asc.	QSUT
3	Olta Noti	Lektor	Dr.	3	Daniela Xhemalaj	Doktor	SU"Shfqet Ndroqi"
4	Erjola Reufi	Lektor	Dr.				
5	Alketa Bakiri	As.Lektor	Msc (Dr.process)				
6	Arjol Rama	As.Lektor	Msc (Dr.process)				
7	Adilta Bejko	Lektore	SPA				
8	Kristaq Goce	Ndihmes akademik	Msc				
9	Kistjana Nasto	Ndihmes akademik	Msc				
Fakulteti i Shkencave të Aplikuara Departamenti "Informatikë e Zbatuar"							
Personeli Akademik Efektiv (Emër Mbiemër)		Detyra në Dep.	Titulli /Grada	Personeli Akademik me Kontratë (Emër Mbiemër)		Titulli /Grada	Institucioni ku punon full time
1	Ilia Ninka	Përgjegës Departamenti	Prof.	1	Ana Ktona	Prof. Asc.	FSHN
2	Xhezair Teliti	Lektor	Prof.	2	Igli Tafaj	Doktor	U. Politeknik
3	Luan Sinanaj	As.Lektor	Msc	3	Robert Shagla	Msc	UET
4	Olta Sinanaj	As.Lektor	Msc				

5	Xhezmije Palushi	As.Lektor	Msc			
6	Gazmira Brahushi	As.Lektor	Msc			
7	Orion Shehu	As.Lektor	Msc			
8	Xhilian Spahiaj	As.Lektor	Msc			

Fakulteti i Shkencave të Aplikuara Qendra për kërkim dhe zhvillim shkencor

Personeli Akademik Efektiv (Emër Mbiemër)		Detyra në Dep.	Titulli /Grada	Personeli Akademik me Kontratë (Emër Mbiemër)		Titulli /Grada	Institucioni ku punon full time
1	Mersin Mersinllari	Përgjegës i Qendrës	Prof	1			
2	Tefta Rota	Lektor	Prof.As	2			
3	Stilian Buzo	Lektor	Dr.				
4	Dorina Minxuri	As.Lektor	Msc				
5	Entela Kostriska	As.Lektor	Msc				

Tabela 4: Të dhënat sipas kualifikimit dhe Raportet midis tyre për stafin akademik të programit të studimit

Stafi akademik për programin e studimit per vitin akademik 2017 - 2018							
Personeli Akademik Efektiv (Emër Mbiemër)		Detyra në Dep.	Titulli /Grada	Personeli Akademik me Kontratë (Emër Mbiemër)		Titulli /Grada	Institucioni ku punon full time
1	Aleksandër Sallabanda	Dekan FSHA/Lector	Prof. Dr.	1	Alma Barbullushi	Prof. Asc. Dr.	QSUT
2	Mersin Mersinllari	Përgj Qën/Lektor	Prof. Dr.	2	Shpëtim Qyra	Prof. Asc. Dr.	ISHP
3	Tefta Rota	Lector	Prof. Asc. Dr.	3	Daniela Xhemalaj	Dr.	SU"Shëfqet Ndroqi"
4	Ritvana Mediu	Shef Dep /Lektor	Dr.				
5	Stilian Buzo	Lektor	Dr.				
6	Eriola Reufi	Lektor	Dr.				
7	Olta Noti	Lektor	Dr.				
8	Kristaq Goce	Ndih.Akademik	Msc				
9	Kristijana Nasta	Ndih.Akademik	Mpr				

Tabela 5: Të dhënat sipas kualifikimit dhe Raportet midis tyre

Titulli	Stafi akademik për programin e studimit		
	PAE	PAK	Raporti PAE/PAK
Profesorë	2	-	2/0
Profesorë të As.	1	2	1/2

DR/PhD	4	1	4/1
Pedagogë në proces Dr	-	-	-
Asistentë me Msc	-	-	-
Personeli Ndihmes akademik	2	-	2/0
Totali	9	3	

Tabelat 6: Të dhëna sipas moshës

Tabela 6/1

Personeli sipas titujve /gradave	Numri i PAE dhe PA me moshë:				
	(25-35)	(36-45)	(46-55)	(56-65)	(66-68)
Profesorë					2
Profesorë të As.					1
DR/PhD	2		1		1
Pedagogë në proces Dr					
Asistentë me Msc					
Personeli Ndihmes akademik			1		1
Totali	2		2		5

Tabela 6/2

Personeli sipas titujve /gradave	Numri i PAK me moshë:				
	(25-35)	(36-45)	(46-55)	(56-65)	(66-68)
Profesorë të As.			2		
DR/PhD		1			
Pedagogë në proces Dr					
Asistentë me Msc					
Personeli Ndihmes akademik					
Totali		1	2		

Tabelat 7: Mjediset e fakultetit

Mjediset për Fakultetin/përgjegjës për programin e studimit	Sasia	Sipërfaqja
Salla për leksione	4	243
Klasa për seminare	2	79
Salla për aktivitete promovuese	1	120
Salla për praktikë lëndore/ profesionale		
Laboratorë për lëndët	3	170
Laboratorë informatike	3	150
Salla interneti		
Salla për bibliotekë	1	100
Mjedis për fotokopjime, librari etj	1	5
Zyrë informacioni për studentët	1	8
Korridore/holle		190
Mjedise sportive	1	250

Mjedise shërbimi për të tretë		
Mjedise për aktivitetet e qeverisë studentore		
Mjedise shlodhëse si kafeteri/ fast-food/etj		
Nyje hidrosanitare për studentët	4	60
Etj....		
Norma m²/për student	8m ² /student	

Mjediset për stafin:	Sasia	Sipërfaqja
Zyra për Dekanin/zv dekanin/ kancelarin	2	50
Zyra për sekretarinë mësimore	1	12
Zyra për departamentet/qëndrat kërkimore	3	30
Zyra për personelin akademik	3	70
Zyrë për financën	1	9
Zyrë për Njësinë e SBC		
Salla për mbledhje	1	60
Mjedis për stafin e shërbimit	1	6
Nyje hidrosanitare për personelin akademik	8	120
Norma m²/për person	10 m ² /për person	

Tabela 8: Të ardhurat dhe financimet e ndryshme në programin e studimit

Të ardhurat nga:	Viti 1	Viti 2
Pushteti qendror	-	
Pushteti vendor	-	
Fonde jopublike:		
Grantet për kërkim dhe kontratat	-	
Konsulencat, shërbimet	-	
Tarifat për dhe gjatë shkollimit	52500000 lekë	
Sponsorizimet		
Shërbimet trainuese (kualifikimi i vazhdueshëm)		
Donacionet, aktivitetet siguroese, fondacione etj	14500000 lekë	
Aktivitetet tregtare (mensa, kafe, bare, residencat, etj)		
Gjithsej		
SHUMA	67000000 lekë	

Tabela 9: Të dhëna për anëtarët e NJSBC

	Anëtarët e NJSBC	Detyra që ka në NJSBC	Sa kohë ka në këtë detyrë
1	Ariol Rama	Kryetar	2017
2	Kostantinos Giakoumis	Ekspert i Jashtëm	2018
3	Xhezmije Palushi	Anëtar	2017
4	Gazmira Brahushi	Anëtar	2017
5	Denajda Cibukaj	Anëtar	2017
6	?	Anëtar (student)	
Fakulteti i Shkencave të Aplikuara			
1	Luan Sinanaj	Kryetar	2017
2	Erjola Reufaj	Anëtar	2017
3	Merikler Mucorovi	Anëtar (student)	(Bachelor)
4	?	Anëtar (student)	(Master Profesional)

Tabela 10: Planet mësimore të licensuara (tabela është plotësuar pjesërisht mbështetur në të dhënat e syllabuseve; tabela 10 e RVB

Viti I (Viti II) (Viti III)	Semestri	ECTS	Orë në javë	Leksione				Seminare				Laborator				Provime
				Lëndë/Module												
7	Histopatologji Klinike e Avancuar	II	6	4	30		15			15				60		
8	Kimi Analitike	II	4	4	30		15			15				60		
9	Biologji Molekulare	II	5	4	30		15			15				60		
10	Praktikë Profesionale	II	6	4								60		60		
11	Provimi Përfundimtar/Mikrotezë Diplome	II	5									50		50		
Totali			60		280		140			120		110		650		

Tabela 11: Ndryshimet në Planet mësimore, krahasuar me programet mësimore të licensuara (të dhënat e pikave 5 dhe 6 nuk korrespondojnë me deklaratimet e tabelave të tjera dhe të syllabuseve)

Lëndë/Module	Semestri	ECTS	Orë mësimore												Gjithsej	Provime			
			Leksione			Seminare			Laborator			Praktikë							
			ECTS	Në auditor	P. e Pavarur	ECTS	Në auditor	P. e Pavarur	ECTS	Në auditor	P. e Pavarur	ECTS	Në auditor	Punë e Pavarur			Orë në auditor	Punë e Pavarur	
1	Metodologji e Kërkimit Shkencor (C) (Ishte)	II	6	3	30	45	3	30	45								60	90	150
	Metodologji e Kërkimit Shkencor (C) (u hoq nga programi)	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-
2	Epidemiologji (B) (Ishte)	II I	6	3	30	45	3	30	45								60	90	150
	Epidemiologji (B) (u hoq nga programi)	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-
3	Kimi Analitike (A) (Ishte)	II	6	3	30	45	3	30	45								60	90	150
	Kimi Analitike (A) (u ndryshua)	II	4	2	30	20	1	15	10	1	15	10					60	40	100
4	Sëmundje infektive (A) (Ishte)	I	6	3	30	45	3	30	45								60	90	150
	Sëmundje Infektive (A) (u ndryshua)	I	4	3	40	35	1	20	5								60	40	100
5	Praktika Profesionale (E) (Ishte)	II I	10										25						250
	Praktika profesionale (E) (u ndryshua)	II	6													25			150
6	Provim Përfundimtar/Mi krotezë Diplome (F) (Ishte)	II I	15																
	Provim Përfundimtar/Mi krotezë Diplome (F)	II	5														50	75	125

(u ndryshua)																				
Ndryshime në Total																				

Tabela 12: Plani mësimor i ndarë sipas Veprimtarive Formuese (A-F)

PLANI MËSIMOR 2017 - 2018			
Tipi i Veprimtarisë (A-F)	Lënda/Moduli	Kreditet	Totali
Veprimtari në disiplina të formimit të përgjithshëm (A)	Sëmundje Infektive	4	8
	Kimi Analitike	4	
Veprimtari në disiplina të formimit karakterizues (B)	Hematologji Klinike e Avancuar	6	30
	Imunologji Klinike e Avancuar	6	
	Bakteriologji Klinike e Avancuar	6	
	Biokimi Klinike e Avancuar	6	
	Analizë Klinike e Avancuar e Gjakut dhe lëngjeve Biologjike	6	
Vepr. në disiplina të Ngjashme dhe/ose integruese (C)	Histopatologji e Avancuar	6	6
Veprimtari në disiplina me zgjedhje (D)	Biologji Molekulare	5	5
	Gjenetikë Mjekësore	5	
Njohuri të tjera formuese si plotësime në gjuhët e huaja, informatikë, stazh, apo praktika (E)	Praktikë Profesionale	6	6
Teza e Diplomës (F)	Provim Përfundimtar/Mikrotezë Diplome	5	5

Tabela 13: Planet mësimore të programit të studimit të lidhura me personelin akademik përkatës

Viti Akademik 2017 – 2018					
Lënda /Moduli	Pedagogu/Pedagogët përgjegjës	Titulli/grada kualifikimi	Departamenti	Statusi PAE apo PAK	
1. Sëmundje Infektive	Tefta Rota	Prof. Asc. Dr.	Kërkimi Shkencor	PAE	
2. Hematologji Klinike e Avancuar	Alma Barbullushi	Prof. Asc. Dr.	Teknikë e Lartë Lab. Mjekësorë	PAK	
3. Imunologji Klinike e Avancuar	Shpëtim Qyra	Prof. Asc. Dr.	Teknikë e Lartë Lab. Mjekësorë	PAK	
4. Bakteriologji Klinike e Avancuar	Aleksandër Sallabanda	Prof. Dr.	Teknikë e Lartë Lab. Mjekësorë	PAE	
5. Biokimi Klinike e Avancuar	Eriola Reufi	Dr.	Teknikë e Lartë Lab. Mjekësorë	PAE	
6. Histopatologji e Avancuar	Daniela Xhemalaj	Dr.	Teknik i Lartë Lab. Mjekësorë	PAK	
7. Analizë Klinike e Gjakut dhe Lengjeve të Tjera Biologjike	Stilian Buzo	Dr.	Kërkimi Shkencor	PAE	

8.	Kimi Analitike	Ritvana Mediu	Dr.	Teknik i Lartë Lab. Mjekësorë	PAE
9.	Gjenetikë Mjekësore/ Biologji Molekulare	Mersin Mersinllari	Prof. Dr.	Kërkimi Shkencor	PAE
10.	Praktikë profesionale	Olta Noti	PhD	Teknik i Lartë Lab. Mjekësorë	PAE

Tabela 14: Ngarkesa totale në auditor për Format e mësimdhënies

Programi i Studimit Master Profesional		
Format e mësimdhënies		Orët totale në auditor
a.	Leksione	280
b.	Seminare	140
c.	Ushtrime	
d.	Laboratore	120
e.	Praktikë lëndore	
f.	Praktikë profesionale	60
g.	Diploma	50
Në total		650

Tabela 15: Format e kontrollit të njohurive

Format e kontrollit të njohurive	Pjesa (në %) ndaj totalit
Ndjekja e lëndës dhe pjesmarrja aktive	10%
Plotësimi i detyrimeve (laboratorike, detyrave të kursit)	-
Testimet gjatë vitit	30%
Provimi përfundimtar	60%
Në total	100%

Tabela 16: Aktivizimi i studentëve në komponentët e aktivitetit të njësisë etj.

Aktiviteti shkencor i IAL	Numri i studentëve të aktivizuar
Për punime shkencore individuale të pedagogëve	3
Për projekte shkencore në rang Departamenti	13
Për projekte shkencore në rang Fakulteti	15
Për projekte shkencore në bashkëpunim me të tjerë	8

Tabela 17: Cilësia në hyrje e studentëve (plotëso Tabelën 17)

Programi i studimit Msc në Teknikë e Lartë në Laboratorë Mjekësorë	Studentë të regjistruar në vitin akademik	Nota Mesatare	Studentë të regjistruar me transferim	Nota Mesatare	Totali i studentëve të regjistruar
2013 – 2014	10	8.16			
2014 – 2015	11	7.23			
2015 – 2016	23	8.05			
2017 – 2018	35	-			
Në total	79				

Tabela 18: Të dhëna për kërkimin shkencor

Aktivite të planifikuara individuale dhe në rang Institucioni në vitet e fundit		
1.	Numri i botimeve nga personeli akademik efektiv i IAL	22
2.	Numri i projekteve kërkimore të fituara	0
3.	Numri i projekteve të zbatuara	0
4.	Numri i aktiviteteve shkencore të organizuara nga IAL	2
5.	Numri i pjesëmarrësve në aktivitete shkencore brenda iAL	40
6.	Numri i kërkimit shkencor me procesin mësimor	5
7.	Numri i studentëve të përfshirë në kërkimin shkencor	65
8.	Numri i Çmimeve Kombëtare	0

Tabela 19: Të dhëna për bashkëpunimin kombëtar dhe ndërkombëtar

Aktivite shkencore individuale dhe në rang Programi studimi në kuadër të bashkëpunimit ndërkombëtar në vitet e fundit		
1	Numri i pjesëmarrësve si partnerë në projekte Kombëtare apo ndërkombëtare	0
2	Numri i Leksioneve dhe seminareve me lektorë të huaj ose orë mësimore)	0
3	Numri i pjesëmarrësve në trainime fushën e kërkimit shkencor jashtë vendit	0
4	Mobiliteti i studentëve nga dhe drejt IAL	0
5	Infrastruktura në funksion të kërkimit shkencor	1
6	Numri i pjesëmarrësve në aktivitete shkencore Jashtë IAL/ jashtë vendit dhe prezantime	7
7	Numri i Çmimeve ndërkombëtare në fushën e kërkimit shkencor.	0